



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/ Republic of Kosovo  
Këshilli Prokurorial i Kosovës  
Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

# Raporti i punës për vitin 2022



Mars 2023

© Këshilli Prokurorial i Kosovës 2023

Publikuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

## SHKURTESAT

KËSHILLI	.....Këshilli Prokurorial i Kosovës
PSH	.....Prokurori i Shtetit
ZKPSH	.....Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
PA	.....Prokuroria e Apelit
PSRK	.....Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PTH	.....Prokuroria Themelore
DKR	.....Departamenti i Krimeve të Rënda
DM	.....Departamenti për të Mitur
DP	.....Departamenti i Përgjithshëm
Sekretariati	.....Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës
Njësiti	.....Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive
ZMNV	.....Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
ZMAVP	.....Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial

## Përmbajtja

<b>I. PJESA E PARË</b> .....	7
Përmbledhje ekzekutive .....	7
1. Vizioni.....	7
2. Misioni .....	8
3. Mandati i Këshillit.....	8
<b>II. PJESA E DYTË</b> .....	9
4. Aktivitetet e Këshillit.....	9
5.1. Zgjedhja e anëtarit të Këshillit nga radhët e Prokurorisë së Apelit .....	9
5.2. Rekrutimi i prokurorëve të Shtetit.....	9
5.3. Procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit .....	10
5.4. Miratimi i Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024 .....	10
5.5. Transferimi dhe avancimi i prokurorëve.....	11
5.6. Trajnimi i prokurorëve .....	12
5.6.1. Zyra e Kryeprokurorit Shtetit.....	13
5.6.2. Prokuroria e Apelit .....	14
5.6.3. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.....	14
5.6.4. Prokuroria Themelore e Prishtinës .....	15
5.6.5. Prokuroria Themelore e Prizrenit .....	15
5.6.6. Prokuroria Themelore e Pejës.....	16
5.6.7. Prokuroria Themelore e Mitrovicës.....	16
5.6.8. Prokuroria Themelore e Gjakovës .....	17
5.6.9. Prokuroria Themelore e Ferizajt .....	17
5.6.10. Prokuroria Themelore e Gjilanit .....	18
5.7. Miratimi i akteve nënligjore, strategjive dhe dokumenteve të tjera .....	18
5.8. Miratimi i vendimeve .....	19
5.9. Aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit.....	19
5.9.1. Takimet me partnerët ndërkombëtarë .....	19
5.9.2. Pjesëmarrja e Kryesuesit në konferenca dhe në tryeza.....	19
5.10. Puna e komisioneve të Këshillit.....	20
5.10.1. Komisionet e përhershme .....	21
5.10.1.1. Komisioni për Çështje Normative .....	21
5.10.1.2. Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel .....	21

5.10.1.3.	Procedurat disiplinore.....	22
5.10.1.4.	Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve .....	23
5.10.1.5.	Komisioni për Administrimin e Prokurorive.....	26
5.10.2.1.	Komisioni për Rekrutim.....	27
5.10.2.2.	Komisioni për Rishqyrtim.....	27
5.10.2.3.	Komisioni për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve.....	27
5.10.2.4.	Paneli vlerësues për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit .....	28
5.10.2.5.	Komisioni për rishqyrtim për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit 28	
5.10.2.6.	Komisioni mbikëqyrës për monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike që rrjedhin nga Plani Strategjik i sistemit prokurorial 2022-2024.....	28
5.10.2.7.	Grupi punues për monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024.....	28
5.10.2.8.	Komisioni Zgjedhor i KPK-së për zhvillimin e zgjedhjeve për anëtarin prokuror të KPK-së nga radhët e PA-së.....	29
5.10.2.9.	Komisioni rekrutues për pozitën e shpallur për Drejtor të Përgjithshëm të SKPK-së dhe Drejtor të NJSHPP-së .....	29
5.10.2.10.	Komisioni për Rishqyrtim për pozitën Drejtor i Përgjithshëm i SKPK-së dhe Drejtor i NJSHPP-së.....	29
<b>III.</b>	<b>PJESA E TRETË</b> .....	<b>30</b>
6.	Buxheti i Këshillit .....	30
6.1.1.	Paga dhe mëditje .....	31
6.1.2.	Mallra dhe shërbime.....	32
6.1.3.	Shërbime komunale .....	35
6.1.4.	Investime kapitale .....	36
6.2.	Të hyrat.....	37
6.3.	Donacionet .....	38
<b>IV.</b>	<b>PJESA E KATËRT</b> .....	<b>39</b>
7.	Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të tjera.....	39
<b>V.</b>	<b>PJESA E PESTË</b> .....	<b>40</b>
8.	Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2022 .....	40
8.1.	Kallëzimet – lëndët penale në punë.....	40
8.2.	Lëndët e bartura nga viti 2021 në vitin 2022 .....	43
8.3.	Lëndët e pranuar gjatë vitit 2022.....	44

8.4.	Lëndët e zgjidhura .....	45
8.5.	Lëndët e pazgjidhura.....	48
8.6.	Lëndët në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura .....	48
8.7.	Krahasimi i lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura mes vitit 2021 dhe 2022.....	49
8.8.	Trajtimi i rasteve me procedura alternative dhe të veçanta.....	50
8.9.	Parashtruesit e kallëzimeve penale .....	51
8.9.1.	Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve madhor të veprave penale (PP).....	51
8.9.2.	Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve të mitur të veprave penale (PPM).....	52
8.9.3.	Kallëzimet penale sipas prokurorive.....	53
<b>VI.</b>	<b>PJESA E GJASHTË</b> .....	<b>54</b>
9.	Aktivitetet e Sekretariatit të Këshillit .....	54
9.1.	Zyra e Drejtorit .....	55
9.1.1.	Auditimi i Brendshëm.....	55
9.1.2.	Certifikimi i lëndëve për pagesë.....	57
9.1.3.	Zyra Ligjore.....	57
9.1.4.	Zyra për Komunikim Publik .....	58
9.2.	Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë.....	59
9.2.1.	Divizioni për Burime Njerëzore.....	60
9.2.2.	Divizioni për Prokurim .....	62
9.2.3.	Divizioni i Administratës.....	64
9.3.	Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme .....	65
9.3.1.	Divizioni për Buxhet dhe Financa .....	66
9.3.2.	Divizioni për Shërbime të Përgjithshme .....	66
9.4.	Departamenti për Teknologji Informative.....	67
9.4.1.	Divizioni i Infrastrukturës (rrjet dhe server).....	69
9.4.2.	Divizioni për Sisteme Elektronike (softuer) .....	73
9.5.	Projekti TIK/SMIL .....	74
<b>VII.</b>	<b>PJESA E SHTATË</b> .....	<b>77</b>
10.	Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.....	77
10.1.	Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial.....	77
10.1.1.	Mbështetja e komisioneve të Këshillit.....	77
10.1.2.	Hartimi i raporteve .....	78
10.1.3.	Aktivitete të tjera.....	78

10.2.	Zyra për Statistika .....	79
10.2.1.	Mbështetja e komisioneve, koordinatorëve nacionalë, DTI-së dhe ZMAVP-së.....	79
10.2.2.	Grumbullimi i të dhënave statistikore, përpunimi i tyre dhe përpilimi i raporteve statistikore .....	80
10.3.	Zyra për Trajnime .....	81
11.	Sfidat .....	82

## I. PJESA E PARË

### Përmbledhje ekzekutive

Raporti i punës për vitin 2022 paraqet aktivitetet dhe veprimtarinë e zhvilluar njëvjeçare të Këshillit Prokurorial të Kosovës në kuadër të realizimit të vizionit dhe mandatit kushtetues dhe ligjor, si institucion i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta, me qëllim të sigurimit të një sistemi prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm.

Ky raport përbëhet nga pjesë të standardizuara të realizimit të punëve gjatë vitit 2022, të cilat pasqyrojnë aspekte të veçanta për Këshillin, me ç'rast në pjesën e parë apo hyrëse janë paraqitur vizioni, misioni, struktura, kompetencat dhe baza ligjore e funksionimit të Këshillit, kurse në pjesën e dytë, aktivitetet e Këshillit, si: zgjedhja e anëtarit të Këshillit, rekrutimi i prokurorëve të Shtetit, përzgjedhja e Kryeprokurorit të Shtetit, transferimi dhe avancimi i prokurorëve, aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit, hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore (rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe vendimeve), dokumentet strategjike dhe aktivitetet e trupave të Këshillit (komisioneve të përhershme dhe komisioneve ad hoc).

Raporti vjetor i punës për vitin 2022 i Këshillit, në pjesën tretë, përmban të dhëna të çmueshme për buxhetin e sistemit prokurorial, me ç'rast vëmendje të veçantë kanë pasur shpenzimet për kategoritë e pagave dhe mëditjeve, mallrave dhe shërbimeve, shpenzimeve komunale dhe investimeve kapitale për të gjitha programet buxhetore të Këshillit.

Në pjesën e katërt të këtij raporti pasqyrohet bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar.

Në pjesën e pestë është paraqitur Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2022, i cili përfshin kallëzimet penale në punë, lëndët e bartura, lëndët e pranuar, lëndët e zgjidhura dhe të pazgjidhura, trajtimin e rasteve me procedura alternative dhe parashtruesit e kallëzimeve penale.

Gjithashtu, në vijimësi të pjesës së gjashtë prezantohen aktivitetet e Sekretariatit në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore, buxhetit dhe financave, shërbimeve të përgjithshme, teknologjisë informative dhe komunikimit publik, si dhe Projekti TIK/SMIL. Ndër të tjera, në këtë dokument të rëndësishëm, në pjesën e shtatë, prezantohet edhe puna e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, e cila ka në fokus mbështetjen e proceseve të shqyrtimit të performancës së prokurorëve, rekrutimit të prokurorëve, përpilimin e raporteve statistikore dhe analitike, mbikëqyrjen e regjistrave në prokurori dhe trajnimin e prokurorëve, ndërsa në fund janë paraqitur sfidat kryesore, me të cilat është ballafaquar Këshilli gjatë vitit 2022.

### 1. Vizioni

Vizioni i Këshillit është një sistem prokurorial që njihet për profesionalizëm, llogaridhënie, paanshmëri dhe që ka besim të lartë të qytetarëve të Kosovës që ofrohet nga shërbimi i prokurorisë, i cili është efikas, efektiv dhe etik.



## 2. Misioni

Misioni i Këshillit është sigurimi i sistemit të pavarur, të paanshëm, profesional dhe efektiv i hetimit dhe i ndjekjes penale nga prokurorë të rekrutuar në bazë të meritës, të vlerësuar në bazë të rezultateve në punë dhe të mbikëqyrur sipas standardeve të larta, i cili siguron zbatimin e ligjit në mënyrë të drejtë e pa dallime dhe i trajton në mënyrë meritore viktimat e krimit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës do të ofrojë mbikëqyrje, menaxhim, analiza, politika efektive dhe administrim të nivelit të duhur për të siguruar që Prokurori i Shtetit ka të gjitha burimet që i nevojiten për të ofruar një shërbim prokuroriale me performancë të lartë, llogaridhënese dhe të qasshme për qytetarët e Kosovës.

## 3. Mandati i Këshillit

Mandati i Këshillit buron nga Kushtetuta dhe ligji, që e përcaktojnë atë si një institucion të pavarur në ushtrimin e funksioneve prokuroriale.

Në muajin mars të vitit 2019 është miratuar Ligji nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili ka përcaktuar detyrat, përgjegjësitë, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Përgjegjësitë kryesore kushtetuese dhe ligjore të Këshillit janë si në vijim:

- a. Siguron që prokurorët të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së të gjitha funksioneve prokuroriale;
- b. Vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të prokurorive sipas ligjit përfshirë edhe numrin e prokurorëve në secilin prokurori;
- c. Rekruton dhe propozon te Presidenti kandidatët për emërim dhe riemërim për prokurorë dhe kryeprokurorë përfshirë edhe Kryeprokurorin e Shtetit;
- d. Përgatit, dërgon dhe mbikëqyrë buxhetin e Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial;
- e. Në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit zhvillon politikat dhe strategjitë prokuroriale për luftimin efektiv të kriminalitetit;
- f. Vlerëson, ngritë në detyrë, disiplinon, shkarkon, transferon dhe ofron mbështetje për trajnimin e prokurorëve;
- g. Zhvillon standardet për rekrutimin, organizimin dhe shpalljen e provimit për kualifikimin e prokurorëve;
- h. Miraton aktet nënligjore në funksion të zbatimit të detyrave dhe përgjegjësi të tij, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- i. Përgatitë raport vjetor për veprimtaritë dhe shpenzimet e Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit si dhe raporton para publikut për zbatimin e objektivave të saj të përcaktuara në mënyrë specifike dhe të bazuar në indikatorë të matshëm.

## II. PJESA E DYTË

### 4. Aktivitetet e Këshillit

Këshilli ka përmbushur mandatin e vet ligjor gjatë vitit 2022 përmes organizimit të takimeve të rregullta, në të cilat janë marrë vendime të ndryshme për procesin e rekrutimit, transferimit, avancimit të prokurorëve, procedurave të disiplinimit dhe procesit të vlerësimit të performancës së prokurorëve, si dhe përmes zhvillimit të aktiviteteve tjera të trupave të Këshillit.

Në këtë aspekt, Këshilli ka menaxhuar buxhetin vjetor të dedikuar për sistemin prokurorial të Kosovës, është angazhuar në përmirësimin e kushteve infrastrukturore për prokurorët dhe për stafin mbështetës, si dhe ka ngritur kapacitetet profesionale të prokurorëve dhe stafit mbështetës, bashkëpunimit, propozimit, koordinimit dhe mbikëqyrjes së trajnimeve të ndryshme, përfshirë kryesisht Akademinë e Drejtësisë, por edhe partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Megjithatë, në radhën e aktiviteteve kryesore të Këshillit përgjatë vitit 2022 mund të përmendim: proceset e rekrutimit të prokurorëve, përfundimin e procedurave për përzgjedhjen e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit dhe propozimin e të njëjtit për dekretim në Zyrën e Presidentit, miratimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024, vlerësimin e performancës, disiplinimin, transferimin, avancimin e prokurorëve dhe zhvillimin e kapaciteteve.

Gjithashtu, trupat e Këshillit kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme në kuadër të realizimit të mandatit të tyre dhe në shërbim të funksionimit dhe mbarëvajtjes së rregullt të sistemit prokurorial.

#### 5.1. Zgjedhja e anëtarit të Këshillit nga radhët e Prokurorisë së Apelit

Përbërja e Këshillit përcaktohet me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Meqenëse anëtares nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit i skadonte mandati më 31 dhjetor 2022, Këshilli ka realizuar të gjitha procedurat e nevojshme dhe ka zgjedhur anëtarin e ri nga kjo prokurori, z. Arian Gashi. Mandati i tij do të fillojë me datë 01 janar 2023 dhe zgjat pesë (5) vite.

Sa i përket zgjedhjes së tre anëtarëve joprokurorë të Këshillit, kompetencë kjo tërësisht e Kuvendit të Kosovës, pjesë e Këshillit është vetëm anëtari nga radhët e fakulteteve juridike, z. Agron Beka, ndërsa ende nuk janë zgjedhur anëtarët nga radhët e Odës së Avokatëve dhe shoqërisë civile.

#### 5.2. Rekrutimi i prokurorëve të Shtetit

Në vazhdim të procesit të filluar gjatë vitit 2021 për rekrutimin e gjashtëmbëdhjetë (16) prokurorëve të rinj, Këshilli, në muajin prill 2022 ka përfunduar të gjitha procedurat dhe ka propozuar 7 prokurorë të rinj ku të njëjtit janë dekretuar nga Presidentja dhe kanë filluar trajnimin fillestar në Akademinë e Drejtësisë.

Po ashtu, në muajin qershor 2022, Këshilli ka hapur konkursin tjetër për rekrutimin e 22 prokurorëve të rinj. Në dhjetor 2022 Këshilli ka përfunduar të gjitha procedurat dhe lista me emrat e 22 kandidatëve më të suksesshëm është dërguar në Zyrën e Presidentes për dekretim.

Ftesa për monitorim u janë dërguar partnerëve ndërkombëtar, të gjitha mediumet dhe organizatat e shoqërisë civile. Procesi i rekrutimit të prokurorëve është monitoruar nga përfaqësues të OSCE, EULEX dhe EUKOJUST.

### 5.3. Procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit

Më 12 janar 2022 Këshilli mori vendimin KPK/Nr. 130/2022 për shpalljen e konkursit për Kryeprokuror të Shtetit dhe në po të njëjtën datë, bazuar në Rregulloren 06/2019 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës, themeloi Panelin Vlerësues dhe Komisionin për Rishqyrtim.

Konkursi u shpall nga data 14 janar 2022 dhe brenda afatit aplikuan gjashtë (6) kandidatë. Me datë 08 shkurt 2022, u konfirmua statusi i kandidatëve që kishin aplikuar dhe me 15 shkurt 2022 kjo listë u miratua nga anëtarët e KPK-së.

Me datë 11 mars 2022 njëri nga kandidatët ofroi dorëheqjen nga kandidatura dhe procesi vazhdoi me pesë (5) kandidatët e mbetur.

Me datë 18 mars 2022, Paneli Vlerësues zhvilloi intervistat për Kryeprokuror të Shtetit dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave duke përfshirë intervistimin, vlerësimin, poentimin, të drejtën në kundërshtim dhe vlerësimin e kundërshtimeve, me datë 06 prill 2022 votoi dhe nominoi kandidatin Blerim Isufaj për emërim në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe me datë 08 prill 2022 i njëjti u propozua në Zyrën e Presidentes.

Lidhur me këtë proces, KPK ka publikuar koncept dokumentet e të gjithë kandidatëve si dhe intervistat janë zhvilluar në prani të përfaqësuesve të OJQ-ve dhe partnerëve ndërkombëtarë dhe janë transmetuar në mediumin publik, Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), i cili mundësoi që secili qytetar të përcjellë këtë ngjarje të rëndësishme në sistemin e drejtësisë.

### 5.4. Miratimi i Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024

Për shkak të skadimit të Planit strategjik 2019-2021, Këshilli, në qershor 2021, filloi procesin e hartimit të Planit të ri për periudhën 2022-2024 dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave, Këshilli në takimin e mbajtur më 15 shkurt 2022 e miratoi këtë Plan dhe Planin e Veprimit.

Po ashtu, Këshilli themeloi Grupin Punues për monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024. Ky grup, ka hartuar dhe dërguar në Këshill raportin e parë gjashtë mujor për zbatimin e Planit dhe është i obliguar që në baza gjashtë mujore të hartojë raporte të tilla.

Një përkrahje shumë domethënëse në gjithë këtë proces kanë ofruar partnerët tanë ndërkombëtarë, të cilët, përmes ekspertizave, ideve, komenteve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, kanë dhënë kontributin e tyre me qëllim të hartimit të një Plani strategjik sa më profesional dhe të arritshëm.

Plani strategjik i sistemit prokurorial 2022-2024 paraqet kornizën kryesore të planifikimit të politikave për menaxhimin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës në tri vitet e ardhshme.

Plani ka për qëllim ngritjen e vazhdueshme të profesionalizmit, efikasitetit dhe menaxhimit të sistemit prokurorial, fuqizimin e pavarësisë, integritetit, llogaridhënies dhe transparencës, gjithnjë duke u mbështetur në kompetencat kushtetuese dhe ligjore.

## 5.5. Transferimi dhe avancimi i prokurorëve

Këshilli, përmes Komisionit për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve, ka zhvilluar disa procese, në vijim:

- Avancimin e një (1) prokurori të shtetit në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Pejë, proces i filluar në fund të vitit 2021 dhe i përfunduar në janar 2022;
- Avancimin e një (1) prokurori të shtetit në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Pejë;
- Avancimin e një (1) prokurori të shtetit në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Gjakovë;
- Në proces, avancimi i tre (3) prokurorëve të shtetit në Prokurorinë e Apelit;

Gjithashtu, Këshilli, gjatë vitit 2022, ka transferuar prokurorët si në vijim:

- Shtatë (7) prokuror të shtetit me transferim të përhershëm nga Departamentet e Përgjithëshme të Prokurorive Themelore, në Departamentin e Përgjithshëm të prokurorisë Themelore në Prishtinë;
- Një (1) prokuror i shtetit me transferim të përhershëm nga Departamenti i Përgjithshëm i Prokurorisë Themelore në Prizren, në Departamentin e Përgjithshëm të prokurorisë Themelore në Ferizaj;
- Një (1) prokuror i shtetit me transferim të përhershëm nga Departamenti për të Mitur në Departamentin për Krime të Rënda brenda prokurorisë Themelore në Ferizaj;
- Tre (3) prokuror të shtetit janë transferuar përkohësisht nga Departamentet e Përgjithshme të Prokurorive Themelore, në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.
- Një (1) prokuror i shtetit është transferuar përkohësisht nga Departamenti i përgjithshëm i Prokurorisë Themelore në Prizren, në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.

## 5.6. Trajnimi i prokurorëve


Trajnimi i vazhdueshëm i prokurorëve të Shtetit mbetet vullnetar bazuar në kornizën ligjore të Këshillit. Megjithatë, prokurorëve u kërkohet që të ndjekin së paku tri trajnime gjatë një viti kalendarik. Në situata të caktuara, me kërkesë të Këshillit apo Kryeprokurorit të Shtetit, trajnimi mund të jetë i detyrueshëm.

Gjatë vitit 2022 kanë marrë pjesë njëqindpesëdhjetë (150) prokurorë të shtetit në aktivitetet e ndryshme të edukimit ligjor, gjithashtu Akademia e Drejtësisë së Kosovës ka angazhuar shtatëmbëdhjetë (19) prokurorë në cilësinë e trajnuesve si dhe janë realizuar 80 tema të trajnimit.


Disa nga temat që prokurorët i kanë ndjekur në trajnime të vazhdueshme lidhen me të drejtën penale materiale dhe atë procedurale, si: hetimi dhe ndjekja e rasteve të dhunës në familje, masat për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurë, marrja në pyetje, shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim, trafikimi i njerëzve dhe kontrabandimi i migrantëve, pastrimi i parave, krimi i organizuar, krimi kibernetik, korrupsioni, krimet ekonomike, etj. Po ashtu, prokurorët kanë marrë pjesë në trajnime me tema për liritë dhe të drejtat e njeriut të përcaktuara me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar, etikë profesionale dhe tema për zhvillim të shkathtësive të buta.

Trajnimet kryesisht janë realizuar nga Akademia e Drejtësisë dhe partnerët, si: Ambasada Amerikane, Ambasada Britanike, Ambasada Holandeze dhe UNDP-ja.

Në vijim pasqyrohen numri i përgjithshëm i prokurorëve dhe pjesëmarrja në trajnime të vazhdueshme:




Grafikoni 1: Pjesëmarrja e prokurorëve në trajnim në të gjitha prokuroritë e Kosovës e shprehur në përqindje




Grafikoni 2: Pjesëmarrja e prokurorëve në trajnim në të gjitha prokuroritë e Kosovës

### 5.6.1. Zyra e Kryeprokurorit Shtetit




Grafikoni 3: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

### 5.6.2. Prokuroria e Apelit




Grafikoni 4: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit

### 5.6.3. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës




Grafikoni 5: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

#### 5.6.4. Prokuroria Themelore e Prishtinës



Grafikoni 6: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Prishtinës


#### 5.6.5. Prokuroria Themelore e Prizrenit



Grafikoni 7: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Prizrenit




### 5.6.6. Prokuroria Themelore e Pejës




Grafikoni 8: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Pejës

### 5.6.7. Prokuroria Themelore e Mitrovicës




Grafikoni 9: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës

### 5.6.8. Prokuroria Themelore e Gjakovës




Grafikoni 10: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Gjakovës

### 5.6.9. Prokuroria Themelore e Ferizajt



Grafikoni 11: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Ferizajt

#### 5.6.10. Prokuroria Themelore e Gjilanit



Grafikoni 12: Pjesëmarrja në trajnime e prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Gjilanit

Në këtë kontekst, në kuadër të bashkëpunimit me Akademinë, Këshilli ka hartuar dokumentin “Politikat e trajnimit për prokurorë dhe staf administrativ të sistemit prokurorial” dhe Planin e nevojave për trajnimin e prokurorëve dhe stafit administrativ, me anë të të cilit është kërkuar nga Akademia që të përgatisë programe trajnimi adekuate dhe të ftojë prokurorë në trajnime sipas specifikave.

#### 5.7. Miratimi i akteve nënligjore, strategjive dhe dokumenteve të tjera

Ndryshimet ligjore të ndërlidhura me sistemin prokurorial kanë obliguar Këshillin që të hartojë dhe miratojë akte nënligjore në kuadër të Planit të punës për vitin 2022.

Gjatë vitit 2022, Këshilli ka miratuar katër (4) rregullore, si në vijim:

1. Rregulloren 01/2022 për zgjedhjen dhe përfundimin e mandatit të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit si dhe Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë;
2. Rregulloren 02/2022 për rekrutimin, provimin dhe emërimin e prokurorëve të Shtetit, me
  - Udhëzues me rregullat e testit kualifikues për kandidatët për prokurorë të shtetit;
  - Udhëzues me rregullat e testit me shkrim për kandidatët për prokurorë të shtetit.
3. Rregulloren 03/2022 për procedurën e rekrutimit dhe përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve profesional;
4. Rregulloren 04/2022 për angazhimin e praktikantëve në sistemin prokurorial;

Këshilli po ashtu ka miratuar edhe udhëzuesit si në vijim:

1. Udhëzim 01/2022 për përdorimin e simboleve dhe vulave në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës;
2. Udhëzues për zbatim të Rregullores për transferimin dhe avancimin e prokurorëve;
3. Udhëzues themelor i referimit për organet parahetuese dhe hetuese disiplinore.

Një proces mjaft i rëndësishëm është finalizuar gjatë vitit 2022 e që është ai i miratimit të Planit Strategjik të sistemit. Ky proces është përshkruar më në detaje në pikën 5.4 të këtij raporti.

Në miratimin e këtyre akteve nënligjore janë angazhuar komisionet dhe trupat e tjerë ndihmës të Këshillit dhe Sekretariatit dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë (ekspertë të angazhuar nga Ambasada Amerikane, Ambasada Britanike, Zyra e BE-së, UNDP-ja, etj).

## 5.8. Miratimi i vendimeve

Këshilli, gjatë vitit 2022, ka marrë 188 vendime nga fushëveprimtaria e vet. Këto vendime kanë të bëjnë me rekrutimin, transferimin dhe avancimin e prokurorëve, disiplinimin dhe vlerësimin e performancës së prokurorëve, administrimin e prokurorëve, menaxhimin e buxhetit, miratimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të punës, procesin e integriteteve evropiane dhe vendime të tjera të cilat i përkasin bashkëpunimit institucional.

## 5.9. Aktivitetet e Kryesuesit të Këshillit

Gjatë vitit 2022, duke u bazuar në kompetencat ligjore për përfaqësimin e Këshillit para publikut, institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, Kryesuesi i Këshillit ka zhvilluar veprimtari përfaqësuese, si: takime, vizita dhe ka marrë pjesë në konferenca, vizita studimore dhe tryeza të ndryshme.

### 5.9.1. Takimet me partnerët ndërkombëtarë

Kryesuesi i Këshillit ka pasur takime të rregullta me përfaqësuesit e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, në kuadër të frymës së bashkëpunimit dhe mbështetjes, të cilat shteti amerikan i ofron gjithnjë për sistemin prokurorial në Kosovë.

Kryesuesi ka zhvilluar takime edhe me përfaqësues të institucioneve të tjera ndërkombëtare, si: të Zyrës së BE-së në Prishtinë, Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, UNDP-së dhe agjencive të tjera të Kombeve të Bashkuara, EULEX-it, Ambasadës së Norvegjisë, Ambasadës së Holandës, Këshillit të Evropës, USAID-it, OSCE-së, GIZ-it etj.

Gjatë këtyre takimeve është biseduar për projektet e ndryshme në mbështetje të sistemit prokurorial të Kosovës, të cilat realizohen në kuadër të financimit dhe përkrahjes së institucioneve të lartcekura.

### 5.9.2. Pjesëmarrja e Kryesuesit në konferenca dhe në tryeza

Në përmbushje të mandatit për përfaqësim të Këshillit, Kryesuesi ka marrë pjesë edhe në konferenca dhe në tryeza pune, si në vijim, në:

- Konferencën Vjetore të Prokurorëve;
- Takimet tremujore të Komitetit Drejtues të Projektit EUKOJUST;
- Forumi për pezantimin dhe diskutimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024, me partnerët ndërkombëtar, mediat dhe shoqërinë civile;
- Tryezë për prezantimin e raporteve për Arkiva, IT dhe Infrastrukturë;
- Punëtori për hartimin e programit për prokurorë të gjeneratës së 9 të prokurorëve të rinj;
- Takimet e Komitetit Drejtues të Strategjisë së Sundimit të Ligjit;
- Punëtori rreth mbrojtjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve të përfshirë në rastet kundër korrupsionit;
- Takime me delegacionet e Komisionit të Venecias lidhur me Draft konceptin e dokumentit për Vetting;
- Takim lidhur me vlerësimin e ekspertëve për përafrimin e Konventës së Stambollit (Këshilli i Evropës dhe Agjencia për Ndihmë Juridike Falas)
- Takimet e Këshillit Ministror për Integrim Evropian;
- Punëtori e përbashkët KPK-KGJK për fazën e katërt të projektit TIK/SMIL;
- Java për të Drejtat e Viktimave të Krimit;
- Takimet e Këshillit për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut;
- Konferencë lansuese e projektit “Mbështetje për Gjykatën Kushtetuese në aplikimin dhe përhapjen e standardeve të të drejtave të Njeriut”;
- Shënimi i ditës së Evropës organizuar nga Zyra e BE-së;
- Takim me delegacionin e Komisionit të Venecias lidhur me Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme;
- Takime me përfaqësues të INL lidhur me projektin e ndërmjetësimit;
- Takimet koordinuese rajonale të Udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme për posedimin, keqpërdorimin dhe trafikimin e paligjshëm të AVL-ve dhe municioneve të tyre”;
- Vizitë studimore në Oslo-Norvegji lidhur me SMIL-in;
- Takim koordinues me partnerët zhvillimor në kuadër të Strategjisë për Sundim të Ligjit;
- Konferencë rajonale në Mal të Zi – Përgjigje më të efektshme gjyqësore ndaj Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në Ballkanin perëndimor;
- Punëtori në Mal të Zi e mbështetur nga projekti britanik WBROLI lidhur me hartimin e kurrikulës trajnuese për KVPP;
- Vizita studimore në Danimarkë dhe Gjermani;

Në kuadër të përfaqësimit të prezantuar më lart, Kryesuesi ka adresuar në vazhdimësi pikëpamjet, punën e Këshillit dhe zhvillimet në sistemit prokurorial, në varësi të agjendave të këtyre forumeve.

#### 5.10. Puna e komisioneve të Këshillit

Këshilli realizon mandatin e vet përmes komisioneve të përhershme dhe atyre që themelohen për një mandat të caktuar – ad hoc. Në vijim do të paraqesim punën e komisioneve gjatë vitit 2021.

### 5.10.1. Komisionet e përhershme

Të gjitha komisionet e përhershme, të cilat funksionojnë në kuadër të Këshillit kanë rregullat e tyre të punës dhe fushëveprimtarinë e ushtrojnë në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, Planet strategjike, Planin e punës së Këshillit dhe planet e punës së komisioneve.

#### 5.10.1.1. Komisioni për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative është themeluar në bazë të ligjit me vendim të Këshillit KPK/nr. 56/2021 në përbërje prej tre anëtarësh. Fushëveprimtaria e Komisionit është rregulluar me Rregulloren nr. 08/2015 për Komisionin për Çështje Normative.

Gjatë vitit 2022, Komisioni ka mbajtur 40 takime, ku përveç anëtarëve të Komisionit kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare që mbështesin punën e Komisionit dhe të sistemit prokurorial në përgjithësi dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Po ashtu, takimet e Komisionit janë mbështetur nga Sekretariati i Këshillit.

Komisioni ka trajtuar dhe hartuar akte nënligjore, përfshirë rregulloret dhe udhëzimet administrative, të cilat janë miratuar në Këshill dhe ka ofruar opinione ligjore sipas kërkesave të Këshillit.

Me qëllim të zbatimit të mandatit të Komisionit dhe bazuar në Planin Strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024, Komisioni ka organizuar vizita informuese në të gjitha prokuroritë e Kosovës, përjashtimisht në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës me qëllim të monitorimit të zbatimit të akteve nënligjore dhe në përfundim ka përgatitur raport përfundimtar për zbatimin e tyre dhe rekomandimet për ndryshimet e akteve nënligjore të cila do të prezantohen në Këshill.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur me datë 13 dhjetor 2022, ka përgatitur Planin e punës për vitin 2023, në përputhje me objektivat dhe Planin Strategjik të sistemit prokurorial.

Komisioni në realizimin e mandatit të tij gjatë vitit 2022 ka bashkëpunuar edhe me komisionet e tjera të Këshillit dhe partnerët ndërkombëtar për t'i harmonizuar dhe unifikuar procedurat e punës dhe organizimit të tyre, dhe të njëjtën do ta vazhdojë në realizimin e objektivat të planit të punës për vitin 2023.

#### 5.10.1.2. Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel

Me Vendimin e Këshillit KPK/nr. 35/2021 është themeluar Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel me përbërje prej tre anëtarësh. Përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Rregulloren nr.05/2017 për Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel. Komisioni ka hartuar Planin e punës për vitin 2022, në bazë të të cilit ka realizuar aktivitetet e planifikuara, me qëllim të zbatimit të përgjegjësive të përcaktuara me rregullore.

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel ka realizuar 09 takime pune gjatë vitit 2022, me ç'rast ka trajtuar çështje të ndryshme për buxhet, financa dhe personel si në vijim:

- Është aprovuar plani i personelit për vitin 2022.
- Është shqyrtuar dhe miratuar Raporti Vjetor Financiar për vitin 2021, si dhe është shqyrtuar buxheti i vitit 2022 sipas programeve buxhetore dhe kategorive ekonomike.
- Është shqyrtuar dhe aprovuar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitin 2023-2025 me kërkesa shtesë lidhur me numrin shtesë të prokurorëve dhe stafit administrativ si dhe mallrave dhe shërbimeve.
- Janë shqyrtuar kërkesa të ndryshme të stafit përfshirë edhe shtesat për staf.
- Është shqyrtuar dhe miratuar Kërkesa Buxhetore për sistemin prokurorial për vitin 2023 si dhe vlerësimet e hershme për vitet 2024-2025, duke përfshi mjete shtesë për paga dhe mëditje dhe mallra dhe shërbime me qëllim të zbatimit të strategjive dhe planeve të Keshillit dhe Prokurorit të Shtetit.
- Janë shqyrtuar raportet periodike financiare të vitit 2022 si dhe janë shqyrtuar shkresa dhe kërkesa të ndryshme për shpenzime dhe transfere të mjeteve si dhe
- Komisioni gjatë këtij viti ka shqyrtuar dhe aprovuar Planin e Prokurimit për vitin 2023.

#### 5.10.1.3. Procedurat disiplinore

Gjatë vitit 2022, Këshilli ka pranuar nëntë (9) kërkesa për fillim të procedurës disiplinore ndaj prokurorëve nga autoriteti kompetent (kryeprokurorët e prokurorive) dhe ka themeluar tetë (8) panele hetimore, ndërsa një kërkesë për inicim të procedurës është refuzuar nga Këshilli Prokurorial

Këshilli, deri më tani, përmes paneleve hetimore, ka zhvilluar procedura disiplinore dhe ka shqiptuar këto masa disiplinore ndaj prokurorëve, të cilat kanë marrë formën përfundimtare, këto masa janë:

Vendimet e Këshillit për lëndët e vitit 2022:

- Vërejtje jo publike me shkrim ( me marrëveshje )
- Vërejtje publike me shkrim ( me marrëveshje )
- Vërejtje publike me shkrim (me marrëveshje)
- Vërejtje publike me shkrim ( në pritje të plotfuqishmërisë së vendimit)
- Është liruar nga përgjegjësia me vendim të KPK por është dërguar në komision të performancës
- Transfer i përhershëm në prokurori tjetër ( në pritje të plotfuqishmërisë së vendimit)
- Një rast i pezulluar deri në përfundim të procedurës penale
- Një rast është themeluar paneli hetimor dhe në pritje të shqyrtimit nga Paneli hetimor

Vendimet e Këshillit për lëndët e vitit 2021 për të cilat shqyrtimi dhe vendimmarrja është marr në vitin 2022:

- Transfer i përhershëm në prokurori tjetër i vërtetuar nga Gjykata Supreme
- Është liruar nga përgjegjësia

- Transfer i përhershëm në prokurori tjetër me vendim të Supremes ulje të pagës për 50 % për 6 muaj
- Është liruar nga përgjegjësia disiplinore dhe është dërguar në komision të performancës
- Vërejtje jo publike me shkrim me marrëveshje për pranimin e fajësisë
- Vërejtje jo publike me shkrim me marrëveshje për pranimin e fajësisë
- Vërejtje publike me shkrim
- Vërejtje jo publike me shkrim
- Është liruar nga përgjegjësia me vendim të KPK

Të gjitha vendimet e formës përfundimtare janë duke u publikuar në uebfaqen e sistemit prokurorial, përveç vërejtjes jopublike me shkrim, siç parashihet me ligj.

#### 5.10.1.4. Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve

Në muajin shkurt 2022, pas grumbullimit të raporteve nga Eprorët, komisioni ka hartuar dhe proceduar në Këshill raportin përmbledhës të vlerësimit të punës vjetore 2021 për 165 prokurorë. Në këtë proces nuk janë përfshirë dymbëdhjetë (12) prokurorë fillestarë për shkak se akoma nuk e kishin plotësuar periudhën kohore për t'iu nënshtruar procesit të vlerësimi, katër (4) prokurorë të cilët në pajtim me ligjin për KPK-në në cilësinë e anëtarit të KPK-së kishin të pezulluar detyrën e prokurorit dhe Kryeprokurori i Shtetit.

Eprorët për vitin 2021 i kanë vlerësuar prokurorët me nivelet si në vijim (*shih tabelën në vijim*):

- Dhjetë (10) prokurorë apo 6% me nivelin “Dalluar”,
- Njëqind e njëzet e katër (124) prokurorë apo 75% me nivelin “Mirë”,
- Njëzet e gjashtë (26) prokurorë apo 16% me nivelin “Mjaftueshëm”
- Pesë (5) prokurorë apo 3% me nivelin “Pamjaftueshëm”.

#	PROKURORË	DALLUAR	MIRË	MJAFTUESHËM	PAMJAFTUESHËM	
1	Kryeprokurorët	9	9			
2	ZKPSH	8	8			
3	Apel	6	6			
4	PSRK	16	15	1		
5	PTh.Prishtinë	40	6	21	8	5
6	PTh.Prizren	20	2	15	3	
7	PTh.Pejë	14		11	3	
8	PTh.Gjilan	12	1	10	1	
9	PTh.Mitrovicë	18		10	8	
10	PTh.Ferizaj	15	1	12	2	
11	PTh.Gjakovë	7		7		
<b>Gjithsej:</b>		165	<b>10 (6%)</b>	<b>124 (75%)</b>	<b>26 (16%)</b>	<b>5 (3%)</b>

Tabela 1: Numri total i prokurorëve të vlerësuar



Në kuadër të kompetencave komisioni për vlerësimin e performancës së prokurorëve gjatë vitit 2022 ka mbajtur 42 takime pune, ka realizuar 18 vizita pune nëpër prokurori, ka kryer shtatë (7) procese të vlerësimit të performancës përmes së cilave është bërë vlerësimi i gjashtëdhjetë e një (61) prokurorëve, prej tyre:

- Dymbëdhjetë (12) prokurorë me mandat fillestar (*në vlerësimin e dytë gjatë mandatit*)
- Dyzet e pesë (45) prokurorë me mandat të përhershëm, për katër (4) prej të cilëve është bërë vlerësimi i parregullt i performancës<sup>1</sup> (*në procesin e III-të*).

Komisioni i ka vlerësuar prokurorët me nivelet si në vijim (*shih tabelën në vijim*):

- Zero (0) me nivelin “Dalluar”,
- Njëzet e nëntë (29) me nivelin “Mirë” apo 48%,
- Tridhjetë e një (31) me nivelin “Mjaftueshëm” apo 51%,
- Një (1) me nivelin “Pamjaftueshëm” apo 2%, që për pasojë, me vendim të KPK-së, është obliguar të vijoj trajnimin e detyrueshëm në Akademinë e Drejtësisë.

Proceset	#prokurorëve	Dalluar	Mirë	Mjaftueshëm	Pamjaftueshëm
Procesi I	12		2	10	
Procesi II	9		6	3	
Procesi III	4			4	
Procesi IV	11		4	6	1
Procesi V	7		3	4	
Procesi VI	10		9	1	
Procesi VII	8		5	3	
<b>Gjithsej:</b>	<b>61</b>	<b>0</b>	<b>29 (48%)</b>	<b>31 (51%)</b>	<b>1 (2%)</b>

Tabela 2: Proceset e vlerësimit

-Në procesin e parë (I) janë vlerësuar dymbëdhjetë (12) prokurorë, në vlerësimin e dytë në kuadër të mandatit fillestar, të cilët janë vlerësuar sipas niveleve si në vijim:

- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin “Dalluar”,
- Dy (2) prokurorë (apo 17%) me nivelin “Mirë”,
- Dhjetë (10) prokurorë (apo 83%) me nivelin “Mjaftueshëm”,
- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin “Pamjaftueshëm”.

-Në procesin e dytë (II) janë vlerësuar nëntë (9) prokurorë me mandat të përhershëm, të cilët janë vlerësuar sipas niveleve si në vijim:

- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin “Dalluar”,
- Tre (3) prokurorë (apo 33%) me nivelin “Mirë”,
- Gjashtë (6) prokurorë (apo 67%) me nivelin “Mjaftueshëm”,

<sup>1</sup> Në procesin e tretë (3) është bërë vlerësimi i parregullt i performancës së katër (4) prokurorëve në pajtim me nenin 8 të Rregullores 05/2020 për vlerësimin e performancës së prokurorëve

- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Pamjaftueshëm".

- Në procesin e tretë (III) janë përfshirë katër (4) prokurorëve me mandat të përhershëm, të cilët në vlerësimin vjetor nga Eprorët ishin vlerësuar me nivelin Pamjaftueshëm. Në pajtim me vendimin e KPK-së, komisioni ka bërë vlerësimin e parregullt dhe i ka vlerësuar me nivelet si në vijim:

- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Dalluar",
- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Mirë",
- Katër (4) prokurorë (apo 100%) me nivelin "Mjaftueshëm",
- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Pamjaftueshëm".

-Në procesin e katërt (IV) janë vlerësuar njëmbëdhjetë (11) prokurorë me mandat të përhershëm, të cilët janë vlerësuar sipas niveleve si në vijim:

- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Dalluar",
- Katër (4) prokurorë (apo 36%) me nivelin "Mirë",
- Gjashtë (6) prokurorë (apo 55%) me nivelin "Mjaftueshëm",
- Një (1) prokuror (apo 9%) me nivelin "Pamjaftueshëm".

-Në procesin e pestë (V) janë vlerësuar shtatë (7) prokurorë me mandat të përhershëm, të cilët janë vlerësuar sipas niveleve si në vijim:

- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Dalluar",
- Tre (3) prokurorë (apo 43%) me nivelin "Mirë",
- Katër (4) prokurorë (apo 57%) me nivelin "Mjaftueshëm",
- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Pamjaftueshëm".

-Në procesin e gjashtë (VI) janë vlerësuar dhjetë (10) prokurorë me mandat të përhershëm, të cilët janë vlerësuar sipas niveleve si në vijim:

- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Dalluar",
- Nëntë (9) prokurorë (apo 90%) me nivelin "Mirë",
- Një (1) prokuror (apo 10%) me nivelin "Mjaftueshëm",
- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Pamjaftueshëm".

-Në procesin e shtatë (VII) janë vlerësuar tetë (8) prokurorë me mandat të përhershëm, të cilët janë vlerësuar sipas niveleve si në vijim:

- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Dalluar",
- Pesë (5) prokurorë (apo 63 %) me nivelin "Mirë",
- Tre (3) prokurorë (apo 37%) me nivelin "Mjaftueshëm",
- Zero (0) prokurorë (apo 0%) me nivelin "Pamjaftueshëm".

Në zbatim obligimeve nga plani strategjik i KPK-së (2022-2024), respektivisht pikës 5.2.3 (Vlerësimi i vazhdueshëm për ndryshimet eventuale të akteve nënligjore që rregullojnë këtë fushë apo procesin në përgjithësi), në Këshill janë proceduar dy dokumente të hartuara nga:

- Anëtarët e KVPP-së dhe koordinatori kanë hartuar dhe proceduar në Këshill rekomandimet për plotësim ndryshimin e rregullores 05/2020 për vlerësimin e performancës së prokurorëve.
- Koordinator i komisioneve të përhershme të KPK-së në bashkëpunim me përgjegjësit e Akademisë së Drejtësisë kanë hartuar dhe proceduar në KPK dhe AD, protokollin nr.1 (si aneks të memorandumit) për zbatimin e trajnimit të detyrueshëm për prokurorët të cilët me vendim të KPK-së obligohen të vijnë trajnimin e detyrueshëm në Akademinë e Drejtësisë.

#### 5.10.1.5. Komisioni për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive, me përbërjen e re të Këshillit, u themelua më 8 shkurt 2021, me Vendimin KPK/Nr. 33/2021, në këtë përbërje: Veton Shabani, kryetar, Sevdije Morina, anëtare dhe Jovo Radoviq, anëtar. Gjatë periudhës raportuese, Komisioni ka realizuar këto aktivitete:

Komisioni për Administrimin e Prokurorive, gjatë vitit 2022 ka mbajtur tetë (8) takime pune.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar vizita në të gjitha prokuroritë themelore nga Komisioni dhe grupi punues i themeluar nga Komisioni. Për shkak të rrethanave specifike në të cilat punon kjo prokurori, me fokus të veçantë ka qenë vizita në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë ku janë diskutuar raportet statistikore që raportohen nga prokurorët dhe shkrimorja, zbatimi i SMIL-it, qasja dhe siguria në objektin e prokurorisë, unifikimi i formularëve, regjistrave, shkresave dhe akteve të prokurorëve si dhe zbatimi i udhëzimeve të detyrueshme të Kryeprokurorit të Shtetit.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe ka organizuar dhe mbajtur një punëtori 2 ditore për ngritjen e efikasitetit në zbatim të SMIL-it ku pjesëmarrës kanë qenë të gjithë administratorët e prokurorive dhe udhëheqësit e shkrimoreve si dhe zyrtarë tjerë që janë të angazhuar me SMIL-in në baza ditore. Gjatë kësaj punëtorie u diskutuan tema lidhur me: pranimin e lëndëve në shkrimore, regjistrimin, shpërndarjen automatike të lëndëve, regjistrimin e veprimeve të prokurorëve që përfshijnë rishikimin e lëndëve, palët, veprat e ndryshme, regjistrimin e kërkesave, seancat, gjenerimin e raporteve statistikore si dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave me gjykatat dhe Policinë. Kjo punëtori u mbështet nga projekti EUKOJUST të cilët po ashtu morën pjesë së bashku me përfaqësuesit e Zyrës së BE-së dhe Këshillit të Evropës.

Pas përfundimit të kësaj punëtorie, prokuroritë themelore të Pejës, Ferizajt dhe Gjilanit kanë ndërmarrë veprime të menjëhershme konkrete në zbatim të rekomandimeve të dala nga punëtorja.

Në takimet e para të Komisionit është miratuar Plani i punës së Komisionit për vitin 2022, që përmban objektiva që janë në përputhje me planet e punës dhe aktet e tjera strategjike të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit.

Komisioni për administrimin e prokurorive ka trajtuar çështjet si: ngarkesa me lëndë të prokurorive dhe numri i nevojshëm i prokurorëve në prokuroritë themelore, monitorimi i zbatimit të SMIL-it në prokuroritë themelore dhe Prokurorinë e Apelit, interesimi i prokurorëve

për transferim në të gjitha prokuroritë e Republikës së Kosovës, mekanizmi i raportimit të kryeprokurorëve, saktësia e shënimeve statistikore të raporteve të SMIL-it, zbatimi i rregullave për qasjen në objekte të sistemit prokurorial, kujdestaria e referentave nëpër prokurori, etj.

Për më tepër janë zhvilluar aktivitete të Grupit punues për monitorimin e zbatimit të Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Rasteve (SMIL) në prokuroritë e vendit, i themeluar nga Komisioni për Administrimin e Prokurorive, ku ka realizuar vizita në të gjitha prokuroritë themelore dhe në Prokurorinë e Apelit me qëllim të identifikimit dhe eliminimit të të gjitha pengesave të paraqitura në punë gjatë zbatimit të SMIL-it. Ky grup punues, në mënyrë të rastësishme ka zgjedhur lëndët dhe ka bërë krahasimin e raporteve manuale me ato elektronike, ka identifikuar fushat e paplotësuara apo të plotësuara gabimisht, detyrat e papërfunduara dhe lëshime tjera që mund të jenë bërë gjatë regjistrimit të lëndëve. Pas përfundimit të secilës vizitë, grupi ka hartuar raporte të cilat i ka dërguar në Komision si dhe tek kryeprokurori dhe administratori i prokurorisë përkatëse të cilët janë udhëzuar për themelimin e grupeve të brendshme punuese për të eliminuar problemet apo gabimet që janë identifikuar.

#### 5.10.2. Komisionet ad hoc

Duke u bazuar në ligjin për themelimin e tij, Këshilli themelon edhe komisionet ad hoc, me qëllim të realizimit të aktiviteteve specifike, ku me vendim përkatës përcakton përbërjen dhe fushëveprimtarinë e tyre.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2022, kanë funksionuar këto komisione ad hoc:

##### 5.10.2.1. Komisioni për Rekrutim

Këshilli themeloi Komisionin për Rekrutim, më 29 korrik 2022, në këtë përbërje: Kryesuesi i Këshillit, Kryesuesi si dhe katër anëtarë tjerë, ndërsa anëtarë rezervë - dy prokurorë. Mandati i këtij Komisioni ishte vlerësimi preliminar i aplikacioneve, përgatitja e testit kualifikues, testit me shkrim dhe intervistës me gojë për kandidatët për prokurorë, kontrollimin e rezultateve të testimit dhe vlerësimin e intervistës me gojë.

##### 5.10.2.2. Komisioni për Rishqyrtim

Këshilli themeloi Komisionin për Rishqyrtim më 29 korrik 2022, në përbërje: Zëvendës Kryesuesi i Këshillit, Kryesuesi i Komisionit, dy anëtarë tjerë të rregullt dhe dy anëtarë rezervë me mandat për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për prokurorë. Pas shqyrtimit të ankesave, të gjithë kandidatët janë njoftuar me shkrim lidhur me vendimet e komisionit.

##### 5.10.2.3. Komisioni për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve

Gjatë vitit 2022, Komisioni për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit ishte në këtë përbërje: u.d. Kryeprokurori i Shtetit në rolin e kryesuesit, dy anëtarë të rregullt dhe tre anëtarë rezervë.

Aktivitetet e këtij komisioni janë përfshirë në transferimin dhe avancimin e prokurorëve në pikën 5.5.

#### *5.10.2.4. Paneli vlerësues për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit*

Më 12 janar 2022, Këshilli, pas tërheqjes së shortit, zgjodhi përbërjen e panelit vlerësues për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit në përbërje nga Kryesuesi i Këshillit në rolin e kryesuesit të panelit dhe katër anëtarë tjerë të rregullt. Ky panel kishte mandat shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve, intervistimin e tyre, poentimin dhe vlerësimin si dhe propozimin e kandidatit më të suksesshëm në Këshill për votim.

#### *5.10.2.5. Komisioni për rishqyrtim për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit*

Më 12 janar 2022, Këshilli, pas tërheqjes së shortit, zgjodhi përbërjen e Komisionit për Rishqyrtim për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit në përbërje prej tre anëtarësh të Këshillit. Ky Komision kishte mandat shqyrtimin e ankesave të kandidatëve.

#### *5.10.2.6. Komisioni mbikëqyrës për monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike që rrjedhin nga Planit Strategjik i sistemit prokurorial 2022-2024*

Pas miratimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024, Këshilli, më 17 maj 2022, themeloi Komisionin mbikëqyrës për monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike që rrjedhin nga Planit Strategjik i sistemit prokurorial 2022-2024, në përbërje prej tre anëtarësh: Zëvendëskryesuesi i Këshillit, një prokuror nga ZKPSH-ja dhe një prokuror nga Prokuroria e Apelit.

Ky grup punues ka mbikëqyru punën e prokurorive themelore për trajtimin dhe zgjidhjen më të shpejtë të lëndëve të pazgjidhura të veprave penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, për të cilën ka raportuar para Këshillit lidhur me të gjitha konstatimet për të gjeturat dhe rekomandimet konkrete.

#### *5.10.2.7. Grupi punues për monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024*

Pas miratimit të Planit strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024, Këshilli, më 16 mars 2022, themeloi Grupin punues për monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024 në përbërje prej tre anëtarësh: Një anëtare e Këshillit, Kryesuese e grupit, u.d. Kryeprokurori i Shtetit dhe një zyrtar nga Sekretariati i Këshillit, anëtarë të grupit.

Mandati i këtij grupi është që të monitorojë zbatimin e planit strategjik dhe në periudha gjashtëmujore të hartojë raport dhe ta prezantojë në Këshill.

*5.10.2.8. Komisioni Zgjedhor i KPK-së për zhvillimin e zgjedhjeve për anëtarin prokuror të KPK-së nga radhët e PA-së*

Duke qenë se mandati i anëtares së Këshillit nga radhët e Prokurorisë së Apelit skadonte më 31 dhjetor 2022, Këshilli sipas afatave ligjore themeloi Komisionin zgjedhor për zhvillimin e zgjedhjeve për anëtarin prokuror të Këshillit nga radhët e kësaj prokurorie. Ky komision kishte përbërje prej tre anëtarësh: anëtari jo prokuror i Këshillit, Kryesues i Komisionit, një prokuror nga ZKPSH dhe një zyrtar nga Sekretariati si dhe tre anëtarë rezervë.

Mandati i këtij Komisioni ishte shqyrtimi i aplikacioneve, organizimi dhe zhvillimi i zgjedhjeve si dhe dërgimi në Këshill i raportit lidhur me mbarëvajtjen e procesit dhe emrin e kandidatit të përzgjedhur.

*5.10.2.9. Komisioni rekrutues për pozitën e shpallur për Drejtor të Përgjithshëm të SKPK-së dhe Drejtor të NJSHPP-së*

Pas shpalljes së konkursit, Këshilli, me datë 21 tetor 2022 themeloi Komisionin rekrutues për pozitën e shpallur për Drejtor të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit dhe Drejtor të NJSHPP-së në përbërje prej pesë anëtarësh: Kryesuesi i Këshillit, kryesues i Komisionit, dy anëtarë të Këshillit, një prokuror nga prokuroritë themelore dhe një zyrtar i lartë nga Sekretariati.

Mandati i këtij Komisioni ishte shqyrtimi i aplikacioneve të kandidatëve, intervistimi, vlerësimi, poentimi dhe propozimi në Këshill i kandidatit më të suksesshëm.

*5.10.2.10. Komisioni për Rishqyrtim për pozitën Drejtor i Përgjithshëm i SKPK-së dhe Drejtor i NJSHPP-së*

Më 08 nëntor 2022, Këshilli themeloi Komisionin për Rishqyrtim për pozitën e shpallur për Drejtor të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit dhe Drejtor të NJSHPP-së në përbërje prej tre anëtarësh: një anëtar i Këshillit, një prokuror nga ZKPSH dhe një zyrtar i lartë nga Sekretariati i Këshillit. Ky Komision kishte mandat shqyrtimin e ankesave të kandidatëve.

### III. PJESA E TRETË

#### 6. Buxheti i Këshillit

Këshilli menaxhon buxhetin vjetor për Këshillin dhe prokuroritë në mënyrë të pavarur dhe mban përgjegjësi për mbikëqyrjen e shpenzimeve, alokimin e fondeve, mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale, si dhe auditimin financiar.

Bazuar në Ligjin Nr.08/L-066 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Këshillit i janë ndarë 17,144,178€, të ndara në katër programe dhe katër kategori ekonomike. Buxheti i Këshillit Prokurorial për vitin 2022 është më i lart për 2,702,650.00 euro se sa buxheti fillestar i vitit 2021, por për 4,553,016 euro më i ulët se sa kërkesa buxhetore e Këshillit për vitin 2022.

Në kuadër të kategorive ekonomike të buxhetit të Këshillit përfshihen: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale dhe shpenzimet kapitale.


Këshilli ka katër programe buxhetore: Prokurorët dhe Administrata, në të cilin përfshihen të gjitha shpenzimet e krijuara nga Këshilli dhe Prokurori i Shtetit, Prokurorët Specialë, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe Njësia Kundër Krimeve Ekonomike.

Gjatë vitit 2022 buxheti i aprovuar i Këshillit ka pësuar ndryshime si rrjedhojë e kërkesave për rialokim dhe transfere nga njëra kategori në tjetrën kategori ekonomike, si dhe kursimeve dhe harmonizimeve me vendime të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Në tabelën më poshtë është paraqitur buxheti fillestar, përfundimtar, ndryshimet gjatë vitit dhe realizimi i buxhetit në katër kategori ekonomike.

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Transferet sipas kërkesës së KPK-së	Ndryshimet në SIMFK	Transferet sipas kërkesës së KPK-së	Buxheti përfundimtar	Realizimi i buxhetit	Realizimi i buxhetit në %
Paga dhe Mëditje	11,184,231				11,184,231	10,627,301	95.02%
Mallra dhe Shërbime	2,375,817	56,898		29,475	2,462,190	2,308,268	93.75%
Shpenzime Komunale	199,630	-		(29,475)	170,155	117,342	68.96%
Investime Kapitale	3,364,500	(56,898)	(2,547,244)		760,358	366,695	48.23%
Rezervat	20,000				20,000		0.00%
<b>Totali</b>	<b>17,144,178</b>				<b>14,596,934</b>	<b>13,419,606</b>	<b>91.93%</b>

Tabela nr. 3 Buxheti dhe realizimi i buxhetit



Grafikoni 13. Realizimi i buxhetit

Realizimi i buxhetit për vitin 2022 është 91.93% për të gjitha kategoritë ekonomike në të gjitha programet buxhetore të Këshillit.

#### Paraqitja e shpenzimeve për të gjitha programet dhe kategoritë ekonomike

Me qëllim të prezantimit të informatave të ndryshme janë të paraqitur më poshtë informata të detajuara të shpenzimeve për secilën kategori të shpenzimeve, në formë përshkruese, në formë tabelore dhe me grafikone për katër programet buxhetore të Këshillit.

##### 6.1.1. Paga dhe mëditje

Bazuar në Ligjin Nr.08/L-066 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, në kategorinë e pagave dhe mëditjeve Këshillit i janë ndarë 11,184,231€, e që është për 412,085.00€ më i lartë se sa buxheti fillestar i vitit 2021.

Në tabelën në vijim janë të pasqyruara shpenzimet për vitin 2022 të ndara sipas kodeve ekonomike dhe programeve buxhetore.

Përshkrimi	Prokuroritë dhe Administrata	Prokuroria Speciale	Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë	Njësia Kundër Krimeve Ekonomike	Totali
Pagat neto	7,506,051	1,101,909	240,008	11,799	8,859,768
Sindikata	6,990	1,261	208		8,459
Tatimi	631,698	100,203	16,874	1,311	750,086
Kontributi i punëmarrësit	427,026	63,336	13,443	690	504,494
Kontributi i punëdhënësit	427,026	63,336	13,443	690	504,494
Vendimet gjyqësore	-				-
<b>Totali</b>	<b>8,998,791</b>	<b>1,330,044</b>	<b>283,976</b>	<b>14,490</b>	<b>10,627,301</b>


Tabela nr. 4 - Pagat dhe mëditjet



Në paga dhe mëditje nga programet buxhetore, buxheti është realizuar 95% në total, ndërsa sipas programeve buxheti është realizuar si në vijim:

- Prokuroritë dhe Administrata kanë realizuar 94.20% të buxhetit;
- Prokuroria Speciale ka realizuar 100% të buxhetit;
- Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave 100% të buxhetit;
- Njësia Kundër Krimeve Ekonomike 100% të buxhetit të ndarë për këtë program.

Përmes grafikoni pasqyrohen shpenzimet për kategorinë e pagave dhe mëditjeve për të gjitha programet buxhetore të Këshillit.



Grafikoni 14. Shpenzimi i pagave dhe mëditjeve

Gjatë vitit 2022 janë mbuluar të gjitha shpenzimet e krijuara për paga dhe mëditje për prokurorë dhe staf administrativ. Nga shuma totale e shpenzimeve në këtë kategori, 84.68% janë shpenzime të programit për prokuroritë dhe administratën, 12.52% për Prokurorinë Speciale, 2,67% për Njësinë për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe 0.14% për Njësinë Kundër Krimeve Ekonomike.

#### 6.1.2. Mallra dhe shërbime

Bazuar në Ligjin Nr.08/L-066 për Buxhetin e vitit 2022, në kategorinë për mallra dhe shërbime Këshillit i janë ndarë 2,375,817.00€, e që ishte për 140,565.00€ më i lartë se sa buxheti fillestar i vitit 2021.

Gjatë vitit 2022, Këshilli ka realizuar 93.75% të buxhetit të ndarë për këtë kategori, ku sipas programeve buxheti është realizuar si më poshtë:

- Prokuroritë dhe Administrata kanë realizuar 93.8% të buxhetit,
- Prokuroria Speciale ka realizuar 97.6% të buxhetit,
- Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave 85.8% të buxhetit,
- Njësia Kundër Krimeve Ekonomike 56.5% të buxhetit të ndarë për këtë program.

Gjatë vitit 2022 janë proceduar për pagesë 7,302 lëndë në kategorinë mallra dhe shërbime.

Në tabelën në vijim është paraqitur buxheti fillestar, ndryshimet buxhetore si dhe shpenzimet sipas programeve dhe kodeve ekonomike të kategorisë mallra dhe shërbime.

Përshkrimi	Kodet ekonomike	Buxheti i aprovuar	Transferi sipas kërkesës së KPK-së	Buxheti përfundimtar	Prokuroritë dhe Administrata	Prokuroria Speciale	Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave	Njësia Kundër Krimeve Ekonomike	Totali
		142,965.00		148,192.12	33,386.22	9,144.54	2,091.00	10,497.36	55,119.12
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	13130	6,000		6,000					-
Mëditja e udhëtimit brenda vendit	13131	19,000		19,000	1,264		624		1,888
Akomodimi i udhëtimeve zyrtare brenda vendit	13132	8,000		8,000			1,467		1,467
Shpenzimet tjera të udhëtimit brenda vendit	13133	-		-					-
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	13140	8,000		8,000					-
Mëditjet	13141	65,200		70,427	23,161	8,003		5,676	36,840
Akomodimi	13142	32,565		32,565	7,547	539		3,600	11,686
Shpenzime tjera	13143	4,200		4,200	1,415	602		1,221	3,238
		149,500		149,500	104,261	4,475	4,032	240	113,009
Shpenzimet e telefonisë mobile	13320	78,700		78,700	59,024	4,085	4,032	240	67,382
Shpenzimet postare	13330	54,300		54,300	29,161	390			29,551
Shpenzimet internet	13310	5,000		5,000	4,424				4,424
Kabllit optik	13340	11,500		11,500	11,653				11,653
		1,006,209		1,006,209	701,974	28,446	-	-	730,420
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	13410	27,000		27,000					-
Shërbimet e përfaqësimit dhe Avokaturës	13420	956,459		956,459	675,910	28,376			704,286
Shërbimet e ndryshme shëndetësore	13430	1,050		1,050	70	70			140
Shërbi. shtypje-jo marketing	13450			-	1,680				1,680
Shërbime të ndryshme intelektuale	13440	700		700	1,009				1,009
Shërbime kontraktuese tjera	13460	21,000		21,000	22,380				22,380
Shpenzimet për anëtarësim	13480			-	800				800
Shërbime teknik	13470			-	75				75
Shpenzimet e varrimit	13490			-	50				50
		50,450	56,898	107,348	93,655	-	-	-	93,655
Mobile	13501	32,000		32,000	19,877				19,877
Telefona	13502	4,050		4,050	4,350				4,350
Kompjuter	13503	2,500	48,748	51,248	48,748				48,748
Hardwer	13504		8,150	8,150	8,140				8,140
Pajisje tjera	13509	11,900		11,900	12,540				12,540
		66,500		66,500	51,678	-	750	-	52,428
Furnizim për zyrë	13610	58,000		58,000	47,284		750		48,034
Furnizim me ushqim dhe pije	13620	3,500		3,500	4,393				4,393
Furnizim Pastrimi	13640			-					-
Furnizim me veshmbathje	13650	5,000		5,000					-
		156,000		156,000	209,103	19,949	15,013	-	244,065
Vaj	13710			-	98				98
Naftë për ngrohje qendrore	13720	44,000		44,000	83,565				83,565
Derivate për gjeneratorë	13770	5,500		5,500	4,144				4,144
Dru	13760	2,000		2,000	3,926				3,926
Karburant për vetura	13780	104,500		104,500	117,370	19,949	15,013		152,332
		136,640		136,640	202,194	2,541	2,118	-	206,853
Regjistrimi i automjeteve	13950	5,520		5,520	3,040	630	310		3,980
Sigurimi i automjeteve	13951	14,500		14,500	12,372	1,831	1,578		15,780
Taksa komunale për regjistrim të veturave	13952	620		620	400	80	230		710
Sigurimi i ndërtesave	13953	116,000		116,000	186,383				186,383
		152,000		152,000	219,570	12,280	4,916	-	236,767
Mirëmbajtja e veturave	14010	39,000		39,000	30,953	5,835	4,916		41,705
Mirëmbajtja e ndërtesave	14020	108,500		108,500	106,998	6,355			113,353
Mirëmbajtja e TI	14040	4,000		4,000	73,584	90			73,674
Mirëmbajtja e mobilieve dhe ndërtesave	14050	500		500	8,035				8,035
		451,792		476,040	326,859	158,280	5,070	-	490,208
Qiraja për ndërtesa	14110	244,500		268,748	155,375	133,363			288,739
Qiraja për pajisje	14130	26,500		26,500	25,636	2,285	1,253		29,174
Qiraja për vetura	14140	180,792		180,792	145,847	22,632	3,817		172,295
		5,280		5,280	3,610	-	1,113	-	4,723
Reklama dhe konkurse	14210			-					-
Botime e publikime	14220	5,280		5,280	3,550		1,113		4,663
shpenzimet për informim publik	14230			-	60				60
		44,480		44,480	37,758	1,038	4,266	785	43,847
Drekat zyrtare	14310	44,480		44,480	37,758	1,038	4,266	785	43,847
		-		-	12,991	-	-	-	12,991
Vendimet e gjykatave	14410			-	12,991				12,991
		14,001		14,001	13,080	11,012	-	-	24,092
Tatimi në qira	14510	14,001		14,001	13,080	11,012			24,092
<b>Totali</b>		<b>2,375,817</b>	<b>56,898</b>	<b>2,462,190</b>	<b>2,010,120</b>	<b>247,165</b>	<b>39,369</b>	<b>11,522</b>	<b>2,308,268</b>

Tabela nr.5 - Shpenzimet sipas programeve dhe kodeve ekonomike në mallra dhe shërbime



Grafikoni 15. Shpenzimet në mallra dhe shërbime

Sipas të dhënave të pasqyruara përmes grafikomit nga shuma totale e shpenzimeve shihet se 87% e shpenzimeve janë mbuluar për programin buxhetor Prokuroritë dhe Administrata, 11% për Prokurorinë Speciale, 2% për Njësinë për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe 0.5% për Njësinë Kundër Krimeve Ekonomike.

### 6.1.3. Shërbime komunale


Buxheti fillestar ë kategorinë ekonomike për shërbime komunale është 199,630.00€, aq sa ka qenë edhe buxheti i vitit 2021.

Në tabelën në vijim janë paraqitur, shpenzimet sipas programeve dhe kodeve ekonomike të kategorisë shërbime komunale.

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Transferi	Buxheti përfundimtar	Prokuroritë dhe Administrata	Prokuroria Speciale	Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave	Totali i shpenzimeve	Totali në %
Rryma	110,000	(17,000)	93,000	67,709	1,824		69,533	74.77%
Uji	11,000	(4,500)	6,500	3,962	295		4,256	65.48%
Mbeturina	6,300		6,300	3,463	-		3,463	54.96%
Ngrohja qendrore	25,730	(4,770)	20,960	13,447			13,447	64.15%
Telefonia fikse	46,600	(3,205)	43,395	22,680	2,475	1,489	26,644	61.40%
<b>Totali</b>	<b>199,630</b>	<b>(29,475)</b>	<b>170,155</b>	<b>111,260</b>	<b>4,593</b>	<b>1,489</b>	<b>117,342</b>	<b>68.96%</b>

Tabela nr. 6 - Shpenzimet komunale

Përmes grafikoneve prezantohen shpenzimet komunale për nënkategoritë ekonomike.



Grafikoni 16. Shpenzimet komunale

Gjatë vitit 2022, Këshilli ka realizuar 69.00% të buxhetit të ndarë për këtë kategori, ku sipas programeve buxheti është realizuar si më poshtë:

- Prokuroritë dhe Administrata ka realizuar 84.5% të buxhetit,
- Prokuroria Speciale ka realizuar 12.9% të buxhetit,
- Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave 49.6% të buxhetit të ndarë për këtë kategori.

Gjatë vitit 2022 janë proceduar 374 lëndë për pagesë në kategorinë e shërbimeve komunale.

#### 6.1.4. Investime kapitale

Buxheti fillestar për kategorinë e investimeve kapitale për vitin 2022 është 3,364,500€ e që është për 2,130,000.00€ më i lartë se sa buxheti i vitit 2021.

Në tabelën nr. 5 është i paraqitur buxheti fillestar, ndryshimet buxhetore, si dhe realizimi i projekteve kapitale.

Nr.	Emri i projektit	Fondi burimor	Nr i projektit	Buxheti Fillestar	Ndryshimet sipas nenit 9 të Ligjit për Buxhetin e vitit 2022	Rialokim i mjeteve qershor	Transferet	Ndryshimi në sistem të SIMFK-së	Buxheti përfundimtar	Realizimi	Realizimi i buxhetit në %
1	Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL)	10	18004	50,000					50,000	4,560	9%
2	Skeneri i kontrollit dhe Sigurisë	10	18059	36,000					36,000		0%
3	Furnizimi dhe instalimi i raftëve lëvizëse për arkiv	10	18064	20,000					20,000	19,937	100%
4	Sistemi Elektronik për menaxhimin e buxhetit dhe financave	10	18058	1,000					1,000		0%
5	Sistemi Elektronik për menaxhimin e rasteve në ZMNV	10	18069	1,000					1,000		0%
6	Instalimi i sistemit të sigurisë kundër zjarrit në arkiva	10	18565	10,000					10,000		0%
7	Blerja e tokës PTH Mitrovicë	10	18566	300,000				(300,000)	0		0%
8	Sistemi elektronik për menaxhimin e dokumenteve	10	18584	6,000					6,000		0%
9	Renovimi i Ndërtesës së PSRK-së	10	18062	200,000	194,596	5,660			400,256	340,428	85%
10	Sistemi elektronik për Menaxhimin e Dosjes së Prokurorëve	10	15217	2,000					2,000	1,770	89%
11	Sistemi elektronik për Menaxhimin e veturave	10	15218	1,000					1,000		0%
12	Avancimi i sistemit për efikasitet të energjisë	10	18568	0					0		0%
13	Salla e konferencave	10	18084	80,000					80,000	0	0%
14	Furnizim me licenca	10	18085	0					0		0%
15	Pajisjet harduerike dhe softuerike të teknologjisë informative	10	18086	60,000			(56,898)		3,102		0%
16	Ndërtimi dhe permisioni i infrastruktures fizike të sistemit prokurorial	10	18570	2,147,500	(194,596)	(5,660)		(1,947,244)	0		0%
17	Mjetet e transportit	10	15216	300,000				(300,000)	0		0%
18	Dizajnimi dhe furnizimi me mobile KPK dhe PSRK	10	18573	150,000					150,000		0%
Totali				3,364,500				(2,547,244)	760,358	366,695	48%

Tabela nr. 7. Projektet kapitale

Gjatë vitit 2022, Këshilli ka realizuar 48.2% të buxhetit të ndarë për këtë kategori.

Mos realizimi i projektit për renovim të objektit të Prokurorisë Speciale ka ndikuar në mos realizim të projekteve Skaneri i Kontrollit dhe Sigurisë, Salla e konferencave si dhe Dizajnimi dhe Furnizimi me mobile KPK dhe PSRK.

## 6.2. Të hyrat

Duke u bazuar në nenin 230, paragrafin 1.2 të Kodit të Procedurës Penale, sistemi prokurorial ka filluar të inkasojë të hyra nga qershori i vitit 2018 në dobi të fondit për kompensimin e dëmit të viktimave të veprave penale dhe në bazë të raportit të të hyrave për sistemin prokurorial. Totali i të hyrave për vitin 2022 është 11,330.00 euro.

Tabela e mëposhtme paraqet inkasimin e të hyrave sipas prokurorive.

Prokuroria Themelore Prishtina	Prokuroria Themelore Pejë	Prokuroria Themelore Mitrovicë	Prokuroria Themelore Gjilan	Prokuroria Themelore Ferizaj	Prokuroria Themelore Prizren	Prokuroria Themelore Gjakovë	Totali
7,450.00	3,000.00	480.00	400.00	-	-	-	11,330.00

Tabela nr. 8 Të hyrat vjetore

### 6.3. Donacionet

Gjatë vitit 2022, Këshilli nga organizatat ndërkombëtare ka përfituar mbështetje me një kosto prej gjithsejtë 1,145,595€.

Mbështetja nga donatorët është ofruar në formë të shërbimeve, pajisjeve të teknologjisë informative dhe buxheti është menaxhuar nga vet donatorët si në tabelën në vijim:

Shpenzimet nga donatorët	Vlera në euro
WBROLI	41,000
EUKOJUST	11,431
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME NORVEGJEZE	1,093,164
<b>TOTALI</b>	<b>1,145,595</b>

Tabela nr. 9 Mbështetja nga donatorët

## IV. PJESA E KATËRT

### 7. Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të tjera

Këshilli ka vazhduar politikën e bashkëpunimit të hapur dhe profesional me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Një bashkëpunim ndërinstitucional i veçantë është zhvilluar me institucionet vendore, si me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Qeverinë e Republikës së Kosovës, Akademinë e Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Odën e Avokatëve të Kosovës dhe Policinë e Kosovës, ndërsa me institucionet, donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, bashkëpunimet më të rëndësishme janë zhvilluar me Ambasadën Amerikane, Zyrën e BE-së në Prishtinë, UNDP-në dhe agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara, Qeverinë e Norvegjisë, EULEX-in, Këshillin e Evropës, IRZ-në, GIZ-in, etj.

Kryesuesi në emër të Këshillit ka nënshkruar këto marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare:

- Me KGJK për implementimin e fazës tranzitore të SMIL-it.
- Me Akademinë e Drejtësisë për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit.
- Me Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës për fuqizimin e komponentës së mësimin klinik.
- Me Doganën e Kosovës për shkëmbimin elektronik.
- Me Chemonics për zbatimin e Projektit britanik regional për krim të organizuar.
- Me Kolegjin UBT dhe universitetin Haxhi Zeka në Pejë lidhur me mundësimin e vizitave të studentëve dhe ligjëratave të ndryshme.
- Me Byronë Kosovare të Sigurimit për shkëmbimin e informacionet, të dhënave dhe dokumentacionit në rastet e aksidenteve në komunikacion dhe kompensimi i dëmit.

Një pjesë e rëndësishme e bashkëpunimit është shprehur edhe në proceset e integritetit evropian, me ç'rast të gjitha kapacitetet e Këshillit janë përgjigjur në çdo kohë ndaj kërkesave për raportim.

Gjatë kësaj periudhe, përveç takimeve të rregullta me partnerët ndërkombëtarë, Këshilli ka mbajtur takim koordinues me partnerët zhvillimor në kuadër të Strategjisë për Sundim të Ligjit ku janë paraqitur nevojat e sistemit prokurorial për përkrahje nga partnerët ndërkombëtar.



## V. PJESA E PESTË

### 8. Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2022

Raporti i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2022 paraqet punën e Prokurorit të Shtetit të realizuar nga të gjitha prokuroritë e Kosovës. Ky raport është hartuar duke u bazuar në të dhënat statistikore të përgatitura nga prokuroritë, të përpunuara në nivel vendi nga zyrat përkatëse në kuadër të sistemit prokurorial.

Raporti ka një strukturë e cila iu mundëson lexuesve që të orientohen dhe të kuptojnë lehtësisht proceset e punës së Prokurorit të Shtetit dhe të informohen për rezultatet e punës, duke i paraqitur ato në mënyrë të thjeshtësuar, nga disa këndvështrime.

Në këtë raport, puna e Prokurorit të Shtetit është paraqitur sipas strukturës si më poshtë:

- Raporti i punës në nivel vendi sipas numrit të kallëzimeve-lëndëve penale të bartura nga viti paraprak, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura;
- Raporti për parashtruesit e kallëzimeve penale;
- Raporti i punës sipas prokurorive;
- Raporti i punës sipas departamenteve; dhe
- Raporti i punës sipas efikasitetit të prokurorive;

#### 8.1. Kallëzimet – lëndët penale në punë

Prokurori i Shtetit (PSH) gjatë vitit 2022 ka pasur në punë gjithsejtë 132,950 kallëzime – lëndë penale (regjistrat: PP, PPM, PPN, NJN, PPP, lëndët e PA-së dhe ZKPSH-së).

Nga ky numër i lëndëve:

- 81,952 ose 61.64% janë të trashëguara/bartura si lëndë të pazgjidhura nga vitet paraprake; dhe
- 50,998 ose 38.35% janë pranuar në punë gjatë vitit 2022;

Gjatë këtij viti, nga ky numër i lëndëve:


- 44,247 se 33.28%<sup>2</sup> e lëndëve në punë gjatë vitit 2022, janë zgjidhur apo proceduar në organet kompetente;
- 88,703 ose 66.71% e të gjitha lëndëve në punë kanë mbetur pa u zgjidhur;

Efikasiteti i lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2022 është:

- 6,751 kallëzime-lëndë penale janë zgjidhur më pak se që janë pranuar gjatë periudhës raportuese, apo


<sup>2</sup> Në këtë numër të lëndëve të zgjidhura hyjnë edhe lëndët e trashëguara nga vitet paraprake.

- 13.23% kallëzime – lëndë penale më pak se që janë pranuar.




Grafikoni 17: Numri i lëndëve në punë, të bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë vitit 2022

Lidhur me numrin e personave që kanë qenë të përfshirë në lëndët me kryes të njohur madhor (PP) dhe të mitur (PPM) që janë trajtuar qofshin ato të bartura, të pranuar, të zgjidhura apo të pazgjidhura kemi situatën si më poshtë:



Grafikoni 18: Numri i rasteve të personave në punë, të bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë vitit 2022

Numri i personave që kanë qenë të përfshirë në lëndët me kryes të njohur madhor (PP) dhe të mitur (PPM) që janë trajtuar qofshin ato të bartura, të pranuar, të zgjidhura apo të pazgjidhura sipas departamenteve kemi situatën si më poshtë:




Grafikoni 19: Numri i rasteve të personave në punë, të bartura, të pranuar, të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë të vitit 2022 në PSRK dhe sipas departamenteve të PTH

## 8.2. Lëndët e bartura nga viti 2021 në vitin 2022

Nga viti 2021 në vitin 2022 janë bartur gjithsej 81,952 lëndë-kallëzime penale në të gjitha departamentet dhe sipas të gjithë regjistrave të prokurorive. Sipas regjistrave për të gjitha llojet e kallëzimeve-lëndëve penale, gjendja e lëndëve të bartura është si më poshtë:

- 7,175 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 8,75%;
- 760 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 0,92%;
- 62,138 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 75,82%;
- 11,269 lëndë të ndryshme penale (PPN/M) ose 13,75%;
- 596 lëndë e ndihmës juridike ndërkombëtare (NJNI) ose 0,72%;
- 0 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 0,% dhe
- 14 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 0,01%.




Grafikoni 20: Kallëzimet - lëndët penale të bartura nga viti 2021

### 8.3. Lëndët e pranuar gjatë vitit 2022

Gjatë vitit 2022 janë pranuar në punë 50,998 kallëzime-lëndë penale, prej të cilave sipas regjistrave në Prokurorinë e Shtetit, janë si më poshtë:

- 23,258 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 45,60%;
- 1,583 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 3,10%;
- 7,414 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 14,53%;
- 9,203 lëndë të ndryshme penale (PPN/M) ose 18,04%;
- 306 lëndë e ndihmës juridike ndërkombëtare (NJN) ose 0,60%;
- 7,804 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 15,30% dhe
- 1,430 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 2,80%.




Grafikoni 21: Kallëzimet – lëndët penale të pranuar në punë gjatë vitit 2022

#### 8.4. Lëndët e zgjidhura


Nga 44,247 kallëzime-lëndë penale që janë zgjidhur gjithsej sipas regjistrave të prokurorive përfshirë këtu edhe ZKPSH-në, Prokurorinë e Apelit dhe PSRK-në, pasqyrohet situata si më poshtë:

- 21,664 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 48,97%;
- 1,662 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 3,75%;
- 2,784 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 6,29%;
- 8,612 lëndë të ndryshme penale (PPN/M) ose 19,46%;
- 292 lëndë e ndihmës juridike ndërkombëtare (NJN) ose 0,66%;
- 7,804 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 17,64 %, dhe
- 1,429 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 3,23%.




Grafikoni 22: Kallëzimet - lëndët penale të zgjidhura gjatë vitit 2022

Norma e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit në vitin 2022 sipas indikatorëve të CEPEJ paraqitet si më poshtë.




Grafikoni 23: Norma e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2022 sipas indikatorëve të CEPEJ (lëndët e zgjidhura në raport me lëndët e pranuar)

Krahasuar me vitin 2020 norma e zgjidhjes së lëndëve sipas indikatorëve të CEPEJ, paraqitet si më poshtë:



Grafikoni 24: Norma e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit mes viteve 2020 v. 2022 sipas indikatorëve të CEPEJ (lëndët e zgjidhura në raport me lëndët e pranuar)

Krahasuar me vitin 2021 norma e zgjidhjes së lëndëve sipas indikatorëve të CEPEJ, paraqitet si më poshtë:




Grafikoni 25: Norma e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit mes viteve 2021 v. 2022 sipas indikatorëve të CEPEJ (lëndët e zgjidhura në raport me lëndët e pranuar)



## 8.5. Lëndët e pazgjidhura

Në fund të vitit 2022, të pazgjidhura kanë mbetur **88,703** kallëzime-lëndë penale, prej të cilave janë:


- 8,769 kallëzime penale të kryesve madhor (PP) të veprave penale ose 9,88%;
- 681 kallëzime penale të kryesve të mitur (PPM) të veprave penale ose 0,76%;
- 66,768 lëndë penale me kryes të panjohur (PPP) të veprave penale ose 75,27%
- 11,860 lëndë të ndryshme penale (PPN/M) ose 13,36%;
- 610 lëndë e ndihmës juridike ndërkombëtare (NJN) ose 0,68%;
- 0 lëndë në Prokurorinë e Apelit (PA) ose 0%, dhe
- 15 lëndë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) ose 0,01%;



Grafikoni 26: Kallëzimet- lëndët penale të pazgjidhura në fund të vitit 2022

## 8.6. Lëndët në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura

Numri i kallëzimeve-lëndëve penale në punë, të zgjidhura dhe ato të mbetura në fund të vitit 2022, sipas regjistrave pasqyrohen në grafikonin në vijim.




Grafikoni 27: Kallëzimet – lëndët penale në punë, të zgjidhura dhe të pazgjidhura në fund të vitit 2022

Sipas pasqyrimit në grafikonin më lartë, numri më i madh i kallëzimeve–lëndëve penale në punë i përket:

- Kryesve të panjohur të veprave penale (PPP), me 69,552 ose 52,31%;
- Kryesve madhor të veprave penale (PP), me 30,433 ose 22,89%;
- Lëndë të ndryshme penale (PPN/M), me 20,472 ose 15,39%.
- Kallëzimet penale të kryesve të mitur (PPM), me 2,343 ose 1,76%;
- Lëndët penale të Prokurorisë së Apelit me 7,804 ose 5,86%;
- Lëndët e ZKPSH-së 1,444 ose me 1,08%.
- Lëndët e ndihmës juridike ndërkombëtare (NJNI) 902 ose me 0,67%.

#### 8.7. Krahasimi i lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura mes vitit 2021 dhe 2022

Në grafikonin në vijim pasqyrohet krahasimi i kallëzimeve–lëndëve penale (PP, PPM, PPN/M dhe PPP) të pranuar dhe të zgjidhura në mes të vitit 2021 dhe vitit 2022:



Grafikoni 28: Krahasimi i lëndëve të pranuar në punë dhe të zgjidhura në mes të vitit 2020 dhe 2021 për regjistrat PP, PPM, PPN/M dhe PPP

Numri i kallëzimeve penale të kryesve madhor (PP) të pranuar në punë gjatë vitit 2022, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, është zvogëluar për 229 kallëzime penale ose 0.97%. Ndërsa numri i kallëzimeve penale të kryesve madhor (PP) të zgjidhura gjatë vitit 2022, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, është zvogëluar për 1655 kallëzime penale ose 7.09%.

Numri i kallëzimeve penale të kryesve të mitur (PPM) të pranuar në punë gjatë vitit 2022, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, është zvogëluar për 166 kallëzime penale ose 9.49%. Ndërsa numri i kallëzimeve penale të kryesve të mitur (PPM) të përfunduara gjatë vitit 2022, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, është zvogëluar për 324 kallëzime penale ose 16.31%.

Numri i lëndëve penale të ndryshme (PPN), të pranuar në punë gjatë vitit 2022, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, është zvogëluar për 357 ose për 3.73% të lëndëve. Ndërsa numri i lëndëve penale të ndryshme (PPN), të përfunduara gjatë vitit 2022, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, është zvogëluar për 1,030 ose për 10.68% të lëndëve.


Numri i lëndëve me kryes të panjohur të veprave penale (PPP), të pranuar në punë gjatë vitit 2022, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, është zvogëluar për 848 ose 10.26%. Ndërsa numri i lëndëve me kryes të panjohur të veprave penale (PPP), të përfunduara gjatë vitit 2022, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021, është zvogëluar për 3,643 ose 56.68%.

## 8.8. Trajtimi i rasteve me procedura alternative dhe të veçanta

Trajtimi i rasteve me procedura alternative synon dhënien e drejtësisë në një kohë sa më të arsyeshme dhe shkarkimin e prokurorëve nga barra e numrit të madh të lëndëve. Po ashtu

procedurat e veçanta (për dhënien e urdhrat ndëshkimor) kanë një rëndësi mjaftë të madhe në punën dhe efikasitetin e PSH-së.

Si rezultat i punës, Prokurori i Shtetit me procedura alternative ka zgjidhur 1,769 raste gjatë vitit 2022 me 3,029 persona. Prej tyre 47 raste me 50 persona me pezullim të përkohshëm të procedurës, 6 raste me 6 persona sipas kushteve kur ndjekja nuk është e detyrueshme, 1,475 raste me 2,661 persona në procedurën e ndërmjetësimit, dhe 241 raste me 312 persona me aktakuzë për marrëveshjen e pranimit të fajësisë.



Grafikoni 29: Lëndët e zgjidhura me procedura alternative

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se nga numri total i rasteve të zgjidhura (21,570 kallëzime penale - PP në të gjitha prokuroritë themelore) nga Prokurori i Shtetit përmes procedurave alternative janë zgjidhur 1,769 raste apo 8,20% e rasteve të zgjidhura PP me 3,029 persona apo 14,04% të personave të zgjidhur PP.


Ndërsa lidhur me aktakuzat me urdhrat ndëshkimor, PSH gjatë vitit 2022 ka zgjidhur 3,179 raste.

## 8.9. Parashtruesit e kallëzimeve penale

Në këtë pjesë do të paraqiten të dhënat lidhur me parashtruesit dhe numrin e parashtruesve të kallëzimeve penale për lëndët të cilat janë pranuar në punë gjatë vitit 2022.

### 8.9.1. Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve madhor të veprave penale (PP)

Gjatë vitit 2022, për lëndët me persona madhor (PP), Prokuroritë Themelore dhe PSRK kanë pranuar në punë gjithsej 23,258 kallëzime penale me 31,767 persona. Këto kallëzime penale janë parashtruar nga:




Grafikoni 30: Parashtruesit e kallëzimeve penale PP

Nga të dhënat statistikore për parashtruesit e kallëzimeve penale, vërehet se numri më i madh i kallëzimeve penale është parashtruar nga Policia e Kosovës me 18,638 kallëzime penale ose 80,13%.

#### 8.9.2. Parashtruesit e kallëzimeve penale të kryesve të mitur të veprave penale (PPM)

Departamentet për të Mitur (DM-të) të Prokurorive Themelore në periudhën raportuese kanë pranuar 1,583 kallëzime penale ndaj 2,443 personave të mitur. Këto kallëzime penale janë parashtruar nga:



Grafikoni 31: Parashtruesit e kallëzimeve penale nga PPM

Nga ky grafikon shihet se numri i më i madh i kallëzimeve penale është parashtruar nga Policia e Kosovës me 1,557 kallëzime ose 98,36% nga të gjitha kallëzimet penale PPM.

### 8.9.3. Kallëzimet penale sipas prokurorive

Mbështetur në statistikën për numrin e kallëzimeve penale të pranuar gjatë vitit 2022, në tabelën në vijim pasqyrohet numri i kallëzimeve penale të pranuar për kryesit madhor (PP), kryesit e mitur (PPM), lëndë të ndryshme penale (PPN) dhe kryesit e panjohur të veprave penale (PPP) sipas kompetencës territoriale të prokurorive themelore dhe PSRK-së:

PTH+PSRK	Regjistri PP		Regjistri PPM		Regjistri PPN		Regjistri PPP		Gjithsej	
	Kallëzimet e pranuar	Nr. i kryesve	Kallëzimet e pranuar	Nr. i kryesve	Kallëzimet e pranuar	Nr. i kryesve	Kallëzimet e pranuar	Nr. i kryesve	Kallëzimet e pranuar	Nr. i kryesve
Prishtinë	7,156	9,219	551	835	2,150	NA	2,673	NA	12,530	10,054
Prizren	2,822	4,079	178	266	1522	NA	1048	NA	5,570	4,345
Pejë	3,125	4,138	182	274	1468	NA	613	NA	5,388	4,412
Gjilan	2,629	3,434	127	198	1184	NA	525	NA	4,465	3,632
Mitrovicë	2,948	3,867	155	230	941	NA	799	NA	4,843	4,097
Ferizaj	2,187	3,106	169	257	939	NA	1067	NA	4,362	3,363
Gjakovë	2,279	3,352	220	382	761	NA	689	NA	3,949	3,734
PSRK	112	572	1	1	238	NA	0	NA	351	573
<b>Gjithsej</b>	<b>23,258</b>	<b>31,767</b>	<b>1,583</b>	<b>2,443</b>	<b>9,203</b>	NA	<b>7,414</b>	NA	<b>41,458</b>	<b>34,210</b>

Tabela 10: Kallëzimet - lëndët penale të pranuar për kryesit madhor (PP), kryesit e mitur (PPM), lëndë të ndryshme penale (PPN) dhe kryesit e panjohur (PPP) të veprave penale sipas prokurorive.

## VI. PJESA E GJASHTË

### 9. Aktivitetet e Sekretariatit të Këshillit

Sipas Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Sekretariati është njësi e themeluar brenda Këshillit, me qëllim të ofrimit të mbështetjes administrative për Këshillin dhe prokuroritë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretariatit janë përcaktuar me Ligjin për Këshillin dhe Rregulloren nr. 09/2016 për veprimtarinë dhe organizimin e brendshëm të vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit.

Struktura organizative e Sekretariatit është e organizuar në këtë mënyrë:

- Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm Sekretariatit me këtë përbërje:
  - Auditori i Brendshëm;
  - Zyrtarët Certifikues;
  - Zyra Ligjore;
  - Zyra për Komunikim Publik dhe
  - Zyrtarët administrativë.
- Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë me këtë përbërje:
  - Divizioni për Burime Njerëzore;
  - Divizioni i Prokurimit;
  - Divizioni i Administratës në kuadër të të cilit funksionojnë:
    - Zyra për Administrim dhe Arkivim;
    - Zyra për Përkthim dhe Lekturim.
- Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme me këtë përbërje:
  - Divizioni për Buxhet dhe Financa;
  - Divizioni për Shërbime të Përgjithshme, në kuadër të të cilit funksionojnë:
    - Zyra për Transport dhe
    - Zyra e Logjistikës dhe Mirëmbajtjes.
- Departamenti për Teknologji Informative me këtë përbërje:
  - Divizioni për Infrastrukturë (Rrjet dhe Server) dhe
  - Divizioni për Sisteme Elektronike (Softuer).

Detyrat dhe përgjegjësitë e njësive organizative të Sekretariatit janë përcaktuar me Rregulloren për organizim të brendshëm.

## 9.1. Zyra e Drejtorit

Zyra e Drejtorit udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit (Drejtori), i cili është zyrtari kryesor administrativ, me përgjegjësi dhe kompetencë kryesore për administrimin dhe menaxhimin e administratës së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit.

I gjithë aktiviteti, shërbimet dhe mbështetja që i është ofruar Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit është e bazuar në Planin strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024 dhe Planet vjetore të punës së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit për vitin 2022. Këto aktivitete janë realizuar nën mbikëqyrjen dhe menaxhimin e drejtpërdrejtë të Drejtorit.

Veprimtaria, menaxhimi dhe administrimi i Zyrës së Drejtorit gjatë vitit 2022 në përgjithësi është fokusuar, por pa u kufizuar në veprimtarinë e auditimit të brendshëm, certifikimit, hartimin e planeve të punës për njësitë organizative të Sekretariatit, hartimin e raporteve, dokumenteve, vendimeve, kërkesave dhe shkresave të ndryshme në mbështetje për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit, e po ashtu dhe në menaxhimin e pandemisë COVID-19.

Po ashtu, aktivitetet e Zyrës së Drejtorit janë përqendruar në mbështetjen e komisioneve të përhershme dhe ad-hoc, në hartimin e planeve të punës dhe raporteve të ndryshme për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit.

Fokus tjetër shumë i rëndësishëm i Zyrës së Drejtorit ishte edhe fusha e integriteteve evropiane, ku është punuar në raporte shumë profesionale për plotësimin dhe zbatimin e kriterëve të parapara për realizim nga sistemi prokurorial.

Rëndësi të veçantë në vitin 2022 ka pasur dhe fusha e komunikimit publik, në të cilën është punuar dhe angazhuar drejt ngritjes së transparencës dhe orientimeve strategjike.

Gjatë vitit 2022, me qëllim të fuqizimit të administratës së sistemit prokurorial në forma të ndryshme, janë zhvilluar aktivitete të shumta të bashkëpunimit me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

### 9.1.1. Auditimi i Brendshëm

Auditimi i Brendshëm si veprimtari e pavarur, mbështet menaxhmentin e subjektit të sektorit publik në përmbushjen e objektivave, gjithnjë duke ofruar siguri objektive dhe këshillim, për të shtuar vlerën e organizatës dhe duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit, efikasitetit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Në ushtrimin e veprimtarisë, NjAB i është përmbajtur parimeve dhe objektivitetit gjatë kohës së auditimit, ashtu siç është përcaktuar në Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Standardeve të Auditimit si dhe Praktikave Profesionale.

Njësia e Auditimit të Brendshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve të brendshme të gjitha njësive strukturale, programeve, aktiviteteve dhe proceseve në organizatë.



Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përcaktuar dhe ka specifikuar auditimet kryesore të cilat lidhen me njësitë e synuara, si:

- Rishikimi i procesit të prokurimit.
- Menaxhimi i shpenzimeve.
- Menaxhimi i parasë së gatshme.
- Menaxhimi i logjistikës.
- Menaxhimi i pasurisë.
- Menaxhimi i personelit.
- Përkrahja e vazhdueshme profesionale.
- Dhënia e këshillave për nëpunësit.

NjAB, gjatë vitit 2022, ka kryer auditime të planifikuara sipas planit vjetor. Këtu përfshihen auditimet e pajtueshmërisë, të cilat kryesisht mbulojnë këto fusha: proceset buxhetore, shpenzimet, të hyrat, paraja e gatshme, menaxhimi i pasurive, të dhënat për pasuritë dhe mirëmbajtja e tyre, prokurimi dhe procedurat e zhvilluara; për punë, furnizime dhe shërbime, auditimi i zhvilluar në prokurorinë Speciale, si dhe angazhimi i auditimit në ZMNV, për të vlerësuar kontrollin e brendshëm. Sipas planit vjetor ishin planifikuar gjithsej pesë auditime dhe janë realizuar të gjitha, shprehur në përqindje 100% e planit është realizuar. NjAB, reflekton në angazhimin sistematik për përmbushjen e objektivave të njësisë me qëllim të funksionimit të organizatës. Informatat tregojnë se me efikasitet është realizuar niveli i planifikuar. Pavarësisht kësaj, NjAB në KPK ende funksionon vetëm me një auditor edhe pse me ligj duhet të jenë së paku tre auditor

- Auditimi në Divizionin e Shërbimeve të Përgjithshme me temë: "Funksionimi i sistemit për shërbimet dhe pasuritë". Ky auditim ka rezultuar me shtatë rekomandime për zbatim;
- Auditimi i përfunduar për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave me temë "Sistemi financiar dhe i pasurisë në ZMNV" janë dhënë pesë rekomandime për zbatim.
- Auditimi për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës me temë: "Funksionimi i sistemit për proceset buxhetore, financiare dhe pasurisë". Në raportin final janë evidentuar katër rekomandime;
- Auditimi për Divizionin e Prokurimit me temë "Funksionimi i sistemit dhe proceset e prokurimit". Në raportin final janë evidentuar tri rekomandime për zbatim;
- Auditimi në Divizionin e Buxhetit dhe Financave me temën: "Funksionimi i sistemit për proceset buxhetore dhe financiare". Në raportin final janë evidentuar tri rekomandime.

Të gjitha të gjeturat dhe rekomandimet ishin trajtuar mirë paraprakisht dhe ishin diskutuar me udhëheqësit e njësisë, të cilët iu kanë nënshtruar auditimit të rregullt. Për këtë vit, sipas planit vjetor, ishin paraparë të auditohen pesë njësi organizative, prej tyre, tri auditime me rrezikshmëri të lartë, një auditim me rrezikshmëri të mesëm dhe një auditim me rrezikshmëri të ulët. Sipas verifikimit për zbatimin e rekomandimeve deri në fund të vitit 2022, janë zbatuar gjithsej 12 rekomandime, ndërsa 10 rekomandime janë në proces të zbatimit.

### 9.1.2. Certifikimi i lëndëve për pagesë

Procesi i certifikimit është procesi i fundit për pagesat e shpenzimeve të krijuara nga aktivitetet e realizuara brenda Këshillit. Si obligime të bartura nga viti 2021 në vitin 2022 janë në shumën totale 155,906.38 €. Për shpenzimet e krijuara brenda vitit 2022 janë certifikuar 7,717 lëndë në shumën totale prej 2,792,304.87 €, duke përfshirë faturat e muajit dhjetor të vitit 2022, të cilat barten si obligime në vitin 2023. Obligimet e bartura nga viti 2022 në vitin 2023 janë 973 lëndë në shumë totale 266,239.99 €.

### 9.1.3. Zyra Ligjore

Zyra Ligjore, në kuadër të Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm, gjatë vitit 2022, ka zhvilluar aktivitetet, si në vijim:

- Ofrimin e mbështetjes ligjore në hartimin e dokumenteve strategjike nga fushëveprimtaria e Këshillit dhe ofrimin e mbështetjes ligjore në hartimin e legjislacionit sekondar.
- Hartimin e më shumë se 180 draftakteve nënligjore nga fushëveprimtaria e Këshillit dhe trupave të tjerë, si:
  - katër draftrregulloreve, të miratuara nga Këshilli dhe dy draftrregulloreve, të cilat janë në procedurë në Komisionin për Çështje Normative;
  - një draftudhëzim administrativ, të miratuar nga Këshilli dhe një draftudhëzim administrativ, i cili është në procedurë në Komisionin për Çështje Normative;
  - shtatë draftmemorandumeve dhe
  - 188 vendime të Këshillit.
- Kontrollimin e pajtueshmërisë së akteve nënligjore të Këshillit me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- Ofrimin e mbi 30 opinioneve dhe analizave ligjore për nevojat e Këshillit dhe trupave të tjerë.
- Përfaqësimin në seanca të ndryshme gjyqësore në Departamentin për Çështjet Ekonomike, Departamentin për Çështje Administrative dhe Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil:
  - mbi gjashtëmbëdhjetë përfaqësime ligjore;
  - hartimin e njëzet e tri përgjigjeve në padi;
  - hartimin e dy ankesave;
  - hartimin e dy përgjigjeve në ankesë;
  - hartimin e dy padive me propozim për caktimin e masës së sigurisë;
  - hartimin e dy përgjigjeve në padi dhe masë të sigurisë;
  - hartimin e tri prapësimeve;
  - hartimin e tetë parashtresave.

- Hartimin dhe shqyrtimin e afro 571 shkresave të ndryshme nga fushëveprimtaria e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe njësisve organizative të tij, duke përfshirë kontrollin ligjor të tyre, gjegjësisht:
  - hartimin e 476 draftvendimeve;
  - hartimin e 69 draftautorizimeve dhe
  - hartimin e 26 kërkesave të ndryshme.
- Ofrimin e mbështetjes profesionale dhe administrative në aktivitetet e Këshillit dhe Komisionit për Çështje Normative.
- Ofrimin e mbështetjes profesionale në grupe punuese dhe në komisionet e ndryshme të Sekretariatit.

#### 9.1.4. Zyra për Komunikim Publik

Zyra për Komunikim Publik e SKPK-së është angazhuar gjatë vitit 2022 dhe ka shtuar përpjekjet e veta për ngritjen praktike të komunikimit efikas, transparent dhe të hapur me publikun dhe mediat, në zbatim të Strategjisë për Komunikim Publik 2021-2023.

Viti 2022 karakterizohet me aktivitete të shtuara nga Zyra për Komunikim Publik e SKPK-së me qëllim të ngritjes së transparencës. Gjatë këtij viti kjo zyre ka komunikuar në baza ditore me mediat, përmes përgjigjeve të ofruara në kërkesat e tyre lidhur me punën e Këshillit. Po ashtu komunikimi me mediat dhe qytetarët është realizuara edhe përmes mjeteve të tjera të komunikimit ku duhet veçuar informatat e përditshme të publikuara në uebportalin e sistemit prokurorial, komunikatat, njoftimet, sqarimet dhe reagimet e përgatitura dhe publikuara. Zyra në vazhdimësi përmes emailit zyrtar ka komunikuar me qytetarët ku ka orientuar ata për të realizuar kërkesat e tyre drejtuar sistemit prokurorial në përgjithësi.

Bashkëpunimi ndërinstitutional në fushën e komunikimit ka pasur ngritje, ku duhet veçuar bashkëpunimin dhe koordinimin me institucionet zbatuese të ligjit, ku në koordinim të plotë janë prezantuar shumë veprime dhe aktivitete të përbashkëta në interes të publikut. Vlen të theksohen punëtorit e organizuara me pjesëmarrje të përbashkët me zyrtarët për media të gjykatave dhe Policisë së Kosovës, punëtori të cilat kanë shërbyer për fuqizimin e bashkëpunimit gjatë punëve të përditshme.

Avancim i komunikimit publik është shënuar edhe në raportet me shoqërinë civile, ky avancim është realizuar përmes bashkëpunimit dhe realizimit të aktivitetet të ndryshme të interesit të përbashkët.

Zyra për Komunikim Publik e SKPK-së në vitin 2022 ka punuar në fuqizimin profesional të zyrtarëve për komunikim publik lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me ngritjen e transparencës, koordinimin dhe unifikimin e komunikimit.

## 9.2. Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë

Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë (DBNJPA), sipas mandatit të përcaktuar në Rregulloren nr.09/2016 për veprimtarinë, organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit, renditet në një nga tri shtyllat e Sekretariatit.

Aktivitetet e Departamentit për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë, kanë qenë të orientuara në përmbushjen e detyrave të përcaktuara si dhe objektivave sipas planifikimit duke u realizuar në kuadër të tri divizioneve, si në vijim:

- ❖ Divizioni për Burime Njerëzore;
- ❖ Divizioni për Prokurim;
- ❖ Divizionit i Administratës, i cili përbëhet nga:
  - ❖ Zyra për Përkthim dhe Lekturim
  - ❖ Zyra për Administrimin dhe Arkivimin e Dokumenteve

Gjatë ushtrimit të kompetencave të saj, në vitin 2022, duke u bazuar në objektivat e departamentit zhvillimet kryesore ishin:

- Hartimi i planit për procedurat e rekrutimit;
- rekrutimi i personelit administrativ sipas planifikimit;
- mirëmbajtja dhe plotësimi me dokumentacion i dosjes së prokuroreve dhe krijimi i dosjes për prokurorët e riijnë;
- realizimi i transferimeve dhe avancimeve e personelit administrativ bazuar në kërkesat dhe nevojat e sistemit duke mundësuar zhvillimin e karrierës brenda sistemit prokurorial;
- zbatimi i sistemit elektronik të burimeve njerëzore (SIMBNJ), sistem ky, që mundëson menaxhimin efikas dhe pasqyrë në kohë reale të të dhënave për të gjithë zyrtarët e administratës së sistemit prokurorial;
- përmes procedurave të prokurimit, është bërë i mundur implementimi i projekteve dhe shërbimeve tjera të nevojshme për funksionimin e sistemit prokurorial;
- është ofruar përkthim i dokumnetacinit, përkthim konsektiv dhe përkthim simultan për Këshillin Prokurorial dhe Prokurorin e Shtetit;
- implementimi i sistemit të arkivave;
- sistemi i arkivave është realizuar në dy drejtime: arkivat fizike të teknologjisë së fundit të cilat krijojnë siguri për dokumentet e arkivuara dhe te lehtësi në qasje, po ashtu zbatimi i sistemit elektronik të arkivimit – ku përmes një baze të të dhënave mundësohet ruajtja dhe shfrytëzimi i dokumenteve të arkivuara;
- është ofruar mbështetje profesionale dhe administrative për panelet hetimore;
- është ofruar mbështetje profesionale dhe administrative për Komisionin e Ankesave dhe Komisionin Disiplinor dhe
- është rritur bashkëpunimi nëpërmjet takimeve me nivele të ndryshme me qëllim të koordinimit, për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në procese të punës.

### 9.2.1. Divizioni për Burime Njerëzore

Në ushtrim të funksionit të Divizionit të Burimeve Njerëzore janë zhvilluar një sërë aktivitetestesh si në vijim:

#### *Proceset e rekrutimit*

Divizioni i Burimeve Njerëzore në zbatim të planifikimit të personelit për vitin 2022 dhe nevojave për plotësim të pozitive të lira ka zhvilluar procedurat të shumta të rekrutimit edhe përkundër mungesës së hapësirave të punës, të pasqyruara si në vijim:

- Gjatë vitit 2022 janë shpallur konkurset për 211 pozita;
- Nga ky numër kanë filluar punën (shtatëdhjetepesë) 75 zyrtarë të rinj dhe (tridhjetegjashtë) 36 janë në proces të emërimit;
- Janë avancuar në karrierë (tridhjeteshtatë) 37 zyrtarë;
- Janë realizuar (katërmëdhjetë) 14 transferime brenda sistemit prokurorial dhe (një) 1 transferim nga institucionet tjera;
- Gjatë këtij viti janë anuluar 63 konkurse dhe shpallje të brendshme në mungesë të kandidateve të mjaftueshëm dhe kandidateve që i kanë plotësuar kriteret dhe nga komisioni i ankesave.

Numri total i zyrtarëve në fund të vitit 2022 ka qenë (gjashtëqindgjashtëdhjetëdy) 662.

#### *Pozitat e liruara*

Gjatë vitit 2022 janë liruara tridhjetetë (38) pozita, lidhur me arsyet si në vijim:

- Pensionime- gjashtëmbëdhjetë (16) zyrtarë;
- Dorëheqje- nëntëmbëdhjetë (19) zyrtarë;
- Pezullim i dakorduar- një (1) pozitë;
- Vdekje e zyrtarit- dy (2) pozita.

#### *Komisioni disiplinor*

Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial gjatë vitit 2022 ka pranuar dhe shqyrtuar 4 raste disiplinore, prej tyre 3 raste për stafin e brendshëm dhe 1 rast disiplinor i rikthyer me vendim të KPMSHCK-së:

- Një (1) vendim i komisionit disiplinor me të cilin është shqiptuar masa disiplinore pezullim i ushtrimit të detyrave dhe ndalim i 1/3 të rrogës për një (1) muaj.
- Një (1) vendim të komisionit disiplinor me të cilin është refuzuar kërkesat për inicimin e procedurës disiplinore.
- Një (1) vendim kur Komisioni Disiplinor është shpallur jo kompetent për vendosje.
- Një (1) vendim i komisionit disiplinor me të cilin është pezulluar procedura.

### *Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave*

Në pajtim me Rregulloren në fuqi me të drejtë ankesë, në Komisionin për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës janë paraqitur 43 ankesa.

- Tridhjeteshtatë (37) ankesa janë paraqitur lidhur me proceset e rekrutimit pas publikimit të njoftimeve;
- Gjashtë (6) ankesa janë të stafit të brendshëm të sistemit prokurorial, tre (3) ankesa për nivelizimin e koeficientëve, një (1) ankesë për shqiptim të masës disiplinore dhe dy (2) ankesa për pagesa retroaktive.

### *Përgjigje ne ankesa të KPMSHCK-së*

Sipas kërkesës se Këshillit Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës janë dërguar (21) njëzetënjë përgjigje në ankesë lidhur me ankesa e ushtruara ne KPMSHCK.

### *Transferimet e zyrtarëve*

Divizioni i Burimeve Njerëzore në vitin 2022, ka realizuar pesëmbëdhjetë (15) transferime në pajtim me legjislacionin në fuqi. Prej tyre, katërmëdhjetë (14) transferime janë realizuar brenda sistemit prokurorial, ndërsa një (1) transferim i jashtëm.

### *Zhvillimi i kapaciteteve të stafit*

Nga Divizioni i Burimeve Njerëzore janë koordinuar dhe caktuar zyrtarët për vijimin e trajnimeve të organizuara nga IKAP-i dhe Akademia e Drejtësisë, për vijimin e një sërë temash të ndryshme të trajnimeve.

Me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të stafit nga DBNJ janë propozuar zyrtarë për vijimin e trajnimeve. Trajnimet janë vijuar nga 649 (gjashtëqindëzetenëntë) zyrtarë.

### *Vendime*

Nga DBNJ janë përgatitur 260 vendime, si në vijim:

- Shtatëmbëdhjetë (17) vendime për pensionim;
- Një vendim (1) për pensionim të parakohshëm;
- Një vendim (1) për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës.
- Një vendim (1) për lejim te studimeve jashtë shtetit;
- Nëntëmbëdhjetë (19) vendime për dorëheqje;
- Njëzetënjë (29) vendime për pushim pa pagesë;
- Pesëmbëdhjetë (15) vendime për transferim brenda sistemit prokurorial;
- Njëzetëdy (22) draft vendime për ushtrues detyre;
- Njëzetekatër (24) draft vendime për pushim pa pagesë, brenda orarit të punës për 2 dhe 1 orë;
- Njëzetëtetë (28) draft vendime për lejimin e pushimit të lehonisë;
- Gjashtëmbëdhjetë (16) draft vendime për kompensimin e shërbyesve civil për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes;
- Tetëdhjeteshtatë (87) vendime për llogaritjen e përvojës së punës dhe pagës jubilarë.

### *Paga*

Divizioni, ka proceduar pagat për tërë të punësuarit e sistemit prokurorial, përfshirë pagesat për punë jashtë orari, kujdestari, pagesa retroaktive, punëtorë të rinj, ndryshime në paga, në total 6,092 formularë.

### *Praktikantët*

Gjatë vitit 2022 janë shpallur konkurse për praktikantë.

Në sistemin prokurorial gjatë vitit 2022 janë pesëdhjetenjë (51) praktikantë që vijojnë praktikën në të gjitha nivelet e prokurorive.

Janë përgatiti dhe procedua gjashtëdhjetedy (62) certifikata për praktikant te cilët kanë përfunduar praktiken e filluar ne vitin 2021.

### *Dosjet e prokurorëve*

Në pajtim me Rregulloren Nr.01/2021 për Dosjen Personale të Prokurorit të Shtetit janë mirëmbajtë dhe janë plotësuar me dokumentacion dosjet e prokurorëve dhe janë krijuar dosjet për prokurorët e rinjë.

Është ofruar mbështetje lidhur me kërkesat eventuale për qasje në dosje.

Numri total i prokurorëve në fund të vitit 2022 ka qenë 181.

### 9.2.2. Divizioni për Prokurim

Gjatë vitit 2022, Divizioni i Prokurimit ka nënshkruar gjithsej 34 kontrata, ka kryer 4 procedura të prokurimit në vlerë të madhe, 11 procedura të Prokurimit në vlerë të mesme, 18 Procedura të Koutimeve të çmimeve dhe 2 procedura me vlerë minimale si në vijim:

#### *Procedurat e prokurimit në vlera të mëdha:*

- Është nënshkruar kontrata “Mirëmbajtja teknike dhe higjienike e objekteve të sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës”.
- Ri tender “Sigurimi fizik i objekteve të sistemit prokurorial të Kosovës. Kontrata është përgatit, pritet të nënshkruhet.
- Ri tender “Furnizimi dhe montimi i mobileve për KPK dhe PSRK”.
- Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve të sistemit prokurorial të Kosovës.

#### *Procedurat e prokurimit në vlera të mesme:*

- Ri - tenderim Shërbime të pastrimit të veturave të Sistemit Prokurorial të Kosovës,
- Furnizim me material zyrtarë për nevojat e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës nesër nënshkruhet kontrata

- Ri-tender Furnizimi dhe vendosja (montimi) i rafteve lëvizëse të Sistemit Prokurorial të Kosovës
- Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative
- Furnizimi, montimi, funksionalizimi i barrierave lëvizëse dhe statike për nevojat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës
- Ri-tender Mirëmbajtja dhe Servisimi i Ashensorëve në objektet e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Shërbim me internet dhe VPN (backup) për nevojat e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës.
- Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve të Sistemit Prokurorial të Kosovës.
- Shërbime të By fesë për Objektivin e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit
- Furnizimi me Karrige Lëvizëse për nevojat e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Ri-tender Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve të TI (zerimi, pajisjet simultante) për nevojat e KPK-së

*Procedurat e prokurimit të kuotimeve të çmimeve:*

- Paisje me qira për organizimin e konferencave të Sistemit Prokurorial
- Mirëmbajtja dhe Servisimi i Kamerave të sigurisë në Sistemin Prokurorial
- Mirëmbajtja higjienike në objektet e Sistemit Prokurorial
- Avancimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Dosjeve të Prokurorëve (SEMDP)
- Ri-tender Furnizim me Letër A4 dhe Polder me kuti 80 mm për nevoja të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Ri-tender Furnizim me licensa softuerike për nevojat e Sistemit Prokurorial
- Furnizimi, montimi, funksionalizimi i Sistemit të alarmit në dyer emergjente
- Kontrollimi Teknik i Ashensorëve në objektet e Sistemit Prokurorial të Kosovës
- Mirembajtja, funksionalizimi dhe furnizimi me Vula për nevoja të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Paisje të përkthimit me qira
- Furnizim me paisje të TI-së për nevojat e Sistemit Prokurorial-për avancimin e Qendrës së të dhënave në Pallatin e Drejtësisë
- Ritender Furnizim me kurora dhe buqeta lulesh
- Ritender Furnizim me Letër A4 e bardhë dhe follder me kuti 80 mm, për nevojat e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Furnizim me paisje tjera për nevojat e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Shtypi dhe Furnizimi i Ligjeve
- Ri-tender Furnizim me pelet për ngrohje për nevoja të Prokurorisë themelore në Mitrovicë
- Furnizim me Material Zyrtar për nevojat e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës
- Ritender Furnizimi me Materiale Promocionale zyrtare të dizajnuar dhe të shtypur për nevojat e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës



*Procedurat e prokurimit për vlerat minimale:*

- Furnizimi dhe montimi me Perde në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit
- Mirëmbajtja dhe kohëzgjatja e hostingut të webportalit të Sistemit Prokurorial të Kosovës

### 9.2.3. Divizioni i Administratës

*Zyra për përkthim dhe lekturim*

Aktivitetet e Zyrës për Përkthim dhe Lekturim janë të bazuara në nevojat dhe kërkesat për shërbime të përkthimit sa më cilësorë në kuadër të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit.

Zyra për Përkthim dhe Lekturim është përgjegjëse për sigurimin dhe lehtësimin e komunikimit efektiv për nevojat e institucionit të KPK-së dhe PSH-së përmes përkthimit të shkresave, dokumenteve, materialeve të ndryshme si dhe të përkthimit simultan dhe konsektiv gjatë mbledhjeve e takimeve të ndryshme në kuadër të këtij institucioni në gjuhën shqipe, serbe, angleze dhe anasjelltas.

Zyra për Përkthim dhe Lekturim ka përkthyer gjithsej 4.855 faqe të materialeve të ndryshme (raporte, rregullore, udhëzime administrative, manuale, vendime, shkresa të ndryshme, komunikata, lëndë, teste për rekrutim të stafit administrativ, etj.) dhe 353 orë përkthim simultan në gjuhën serbe dhe angleze dhe anasjelltas gjatë mbledhjeve të KPK-së, komisioneve të përhershme, seancave të prokurorëve me palë, intervistave gjatë rekrutimit të stafit administrativ, etj.

*Zyra për Administrimin dhe Arkivimin e Dokumenteve*

Zyra për Administrimin dhe Arkivimin e Dokumenteve në kuadër të përgjegjësive ka administruar me dokumente të ndryshme duke bërë pranimin, kontrollimin, klasifikimin dhe evidentimin e dokumenteve; përpunimin administrativo-teknik të akteve dhe lëndëve; dërgimin e akteve përkatësisht të lëndëve në procedim të mëtutjeshëm; pranimin dhe dërgimin e postës, shpërndarja e lëndëve dhe akteve; ruajtjen e dokumenteve zyrtare, sistemimi dhe regjistrimin e dokumenteve në E-arkivi.

Puna e kësaj zyre pasqyrohet dhe ruhet në librin e protokollit i cili gjatë vitit 2022 është mbyllur me numrin e fundit rendor 2278, librat evidentuese për regjistrimin dhe procedimin e faturave të pranuar si dhe librat e ekspedicionit.

Dokumente të proceduara të cilat janë evidentuar në librin protokollit janë gjithsej 2278 dokumente të ndryshme, nga të cilat 648 janë shkresa hyrëse, 733 shkresa dalëse, 740 vendime si dhe lloje tjera të dokumenteve me emërtime si: raporte të ndryshme, autorizime, kontrata, parashtrësia, plane të punës, marrëveshje dhe memorandumë bashkëpunimi, rregullore, deklarata, miratim i deklaratave etj.

Janë pranuar gjithsej 6796 fatura nga prokuroritë të cilat janë pranuar nëpërmjet akteve përcjellëse, janë kontrolluar dhe proceduar tek Divizioni për Buxhet dhe Financa.

*Zyrtarët për Ofrimin e Mbështetjes në Panelet Hetimore*

Sipas Ligjit nr. 06/L - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokuroreve dhe Rregullores nr.05/2019 për procedurën disiplinore të prokurorëve, mbështetja profesionale dhe administrative për panelet hetimore duhet të sigurohet nga zyrtarët e KPK-së, zyrtarë të ish ZPD-së, të cilët janë të vendosur në Divizionin për Administratë.

Andaj, në kuadër të mbështetjes së Paneleve Hetimore, Divizioni për Administratë ka ofruar mbështetje profesionale dhe administrative për tetë (8) panele hetimore të themeluara nga KPK-ja përfshirë edhe:

- sigurimin e zbatimit efikas të procedurave hetimore, shërbimeve të nevojshme për zbatimin e Ligjit dhe rregullores, mandateve dhe funksioneve të institucionit;
- pjesëmarrje në seanca konsultative, dëgjimore dhe disiplinore (procesverbalet e seancave);
- përgatitja e draftit të raportit për gjetjet e hetimeve për panelin hetimor;
- draftimi i vendimeve të seancave disiplinore të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- draftimi i përgjigjes në ankesën për Gjykatën Supreme të Kosovës.

### 9.3. Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Bazuar në Rregulloren nr. 09/2016 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, funksionon edhe Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (më tej DBFSHP).

Aktivitetet e DBFSHP-së realizohen përmes:

- ❖ Divizionit për Buxhet dhe Financa dhe
- ❖ Divizionit për Shërbime të Përgjithshme, i cili përbëhet nga:
  - ❖ Zyra për Transport dhe
  - ❖ Zyra e Logjistikës dhe Mirëmbajtjes.

Si aktivitete kryesore dhe të përgjithshme në kuadër të DBFSHP-së janë:

- identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për gjithë sistemin;
- përgatitja e draftit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe draftit të Buxhetit vjetor për vitin 2023 dhe vlerësimet e hershme 2024-2025;
- menaxhimi dhe mbikëqyrja e buxhetit të vitit 2022;
- analiza dhe vlerësimi i shpenzimeve dhe buxhetit në baza të rregullta;
- sigurimi i shërbimeve të përgjithshme për gjithë sistemin prokurorial;
- sigurimi i zbatimit të projekteve kapitale sipas planifikimeve;
- përgatitja e raportit dhe pyetesorit të vetëvlerësimit për vitin 2021;

- bashkëpunimi dhe koordinimi i ngushtë me Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel;
- bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve brenda dhe jashtë Këshillit për çështje që lidhen me buxhetin, financat dhe shërbimet e përgjithshme;
- koordinimi dhe bashkëpunimi i procesit të auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2021 dhe auditimit të ndërmjetëm për vitin 2022 etj.

Vlen të theksohet se te Raporti final i auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2021, opinioni është i pamodifikuar, që do të thotë se pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me vetëm një rekomandim të ri.

Buxheti dhe ekzekutimi i buxhetit për vitin 2022 është pasqyruar në detaje në pjesën e tretë të këtij raporti.

### 9.3.1. Divizioni për Buxhet dhe Financa

Në kuadër të Divizionit për Buxhet dhe Financa janë realizuar aktivitete që kanë të bëjnë kryesisht me planifikimin e buxhetit dhe menaxhimin e financave për gjithë sistemin prokurorial.

Ndër aktivitetet më të rëndësishme në fushën e buxhetit dhe financave përfshihen:

- përgatitja e planifikimeve buxhetore;
- përgatitja e rrjedhës së parasë së gatshme;
- zbatimi i buxhetit sipas planifikimeve;
- përgatitja e Pasqyrave Vjetore Financiar dhe raporteve periodike financiare;
- zotimi, shpenzimi dhe regjistrimi i mjeteve buxhetore sipas planifikimeve;
- regjistrimi i të hyrave;
- ruajtja dhe arkivimi i lëndëve financiare;
- përgatitja e kërkesave të ndryshme për ndryshimin dhe harmonizimin e buxhetit brenda programeve buxhetore dhe kategorive ekonomike;
- raportimet e rregullta sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- barazimi i shpenzimeve dhe të hyrave dhe
- zbatimi i rekomandimeve të auditimit etj.

### 9.3.2. Divizioni për Shërbime të Përgjithshme

Me qëllim të sigurimit të kushteve dhe plotësimit të nevojave për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit janë bërë planifikime dhe janë kryer aktivitete të ndryshme, që kanë të bëjnë me furnizime, mirëmbajtje dhe shërbime të fushave të ndryshme për gjithë sistemin prokurorial.

Janë përgatitur dhe propozuar akte dhe plane të ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e aktiviteteve të përgjithshme dhe janë siguruar, menaxhuar dhe zbatuar kontrata dhe projekte kapitale sipas planifikimit për këtë vit.

Këshilli ka arritur t'i sigurojë disa nga projektet e rëndësishme për sistemin prokurorial, që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe sigurimin e infrastrukturës fizike dhe hapësirave të punës, ngritjen e nivelit të sigurisë, investimeve dhe furnizimeve të tjera, me qëllim të ngritjes së nivelit të kushteve dhe shërbimeve për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit.

Ndër projektet që mund të veçohen për këtë vit janë:

- projektit për renovim të PSRK-së;
- projektit për furnizim me raftë lëvizëse për arkivat e prokurorive;
- projekti për skener të kontrollit dhe sigurisë;
- projekti për alarmet e dymave emergjente si dhe
- projekti për dizajnim dhe furnizim me mobile KPK dhe PSRK.

Sipas marrëveshjes mes KPK, KGJK dhe MPB-së në fund të këtij viti nga MPB ka filluar zbatimin e kontratës për hapjen e dritareve në Pallatin e Drejtësisë, projekt ky që do të plotësojë kërkesat dhe nevojat në këtë objekt.

Divizioni për Shërbime të Përgjithshme ka realizuar aktivitete të ndryshme që ndërlidhen me furnizime dhe shërbime të ndryshme për sistemin prokurorial, me ç'rast janë proceduar 345 lëndë për shërbime dhe furnizime të ndryshme sipas planifikimit, 1,337 kërkesa kërkesa të ekzekutuara, 30 lëndë të regjistruara në sistemin e E-pasurisë, 480 lëndë të regjistruara në SIMFK, 43 vendime dhe autorizime të lëshuara për përdorim të automjeteve zyrtare dhe 192 urdhra të punës për mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve.

Çështje tjera me rëndësi janë sigurimi, menaxhimi dhe shpërndarja e furnizimeve të ndryshme sipas nevojave dhe kërkesave, janë kryer të gjitha mirëmbajtjet dhe shërbimet e tjera të objekteve dhe pajisjeve të sistemit prokurorial, realizimi i donacionit nga Ambasada Norvegjeze, kyqja e ngrohjes së qytetit në objektin e Prokurorisë Themelore Gjakovë si dhe sigurimi i ndërtesave përmes Policisë së Kosovës, etj.

Gjatë këtij viti janë kryer edhe procese tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin e pasurisë jofinanciare të sistemit prokurorial, si: regjistrimi, barkodimi, inventarizimi, vlerësimi dhe tjetërsimi i pasurisë jo financiare.

#### 9.4. Departamenti për Teknologji Informative

Bazuar në Rregulloren nr. 09/2016 për veprimtarinë, organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës funksionon edhe Departamenti për Teknologji Informative ( më tej DTI).

Aktivitetet e DTI-së realizohen përmes:

- ❖ Divizionit të Infrastrukturës (rrjet dhe server) dhe

❖ Divizionit për Sisteme Elektronike (softuer).

Si aktivitete kryesore dhe të përgjithshme në kuadër të DTI-së janë:

- Gjatë vitit 2022, Departamenti i TI-së ka punuar në realizimin e prioriteteve, të cilat janë shtyllat e Planit strategjik, që ka për qëllim avancimin e digjitalizimit të punës së prokurorisë (e-prokuroria).
- Është vënë në zbatim Rregullorja për menaxhimin e Procesit të punës përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve.
- Është përgatitur Projekti TIK/SMIL të Fazës Tranzitore për periudhën 2022 – 2024 për gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës. Projekti financohet nga ambasada Norvegjeze.
- Janë përgatitur dhe nënshkruar:
  - Marrëveshja për bashkëpunim në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për implementimin e Fazës Tranzitore (Fazës së katërt) të projektit Sistemi për Menaxhimin Elektronik të Lëndëve në gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës.
  - Memorandumi i bashkëpunimit në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe të Doganës së Kosovës, që ka për qëllim ndërlidhjen e sistemeve elektronike dhe shkëmbimin e të dhënave në formë elektronike.
  - Konfrom kontratës ndërmjetëm Ministrisë së Punëve Brendshëm dhe PTK, është nënshkruar marrëveshja në mes të KPK dhe PTK mbi shfrytëzimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese.
- Janë përgatitur procedurat standarde në fushën e TIK:
  - Procedura standarde e operimit për shkëmbimin elektronik të të dhënave në mes të prokurorisë dhe Administratës Tatimore të Kosovës.
  - Është finalizuar Draft Procedura Standarde të Veprimit për shfrytëzimit të përbashkët (KPK dhe KGJK) të Qendrës së të dhënave në Pallatin e Drejtësisë.
- Implementimi dhe zbatimi i Projektit TIK/SMIL, SMIL është duke zbatuar në të gjitha Prokurorit Themelore, Prokurorinë Speciale dhe Prokurorinë e Apelit ndërsa në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit nga data 1 janar kemi filluar në vënien në zbatim të sistemit ku janë duke ofruar asistencë/trajtime në tavolinën e punës për prokurorët dhe stafin administrativë.
- Zbatimi i sistemit elektronik për menaxhimin e rasteve në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave.
- Investime në infrastrukturën harduerike – pajisje të TI për sistemin prokurorial.
- Implementimi i rrjetit (Internetit) sekondar (backup) për të gjitha prokuroritë.
- Zhvillimi, avancimi dhe vënien në zbatim të sistemeve të tjera elektronike: sistemi elektronik për menaxhimin e dosjeve të prokurorëve, sistemi elektronik për menaxhimin e veturave, sistemi i rasteve të profilit të lartë – PSRK etj..
- Ngritja e nivelit të sigurisë së informacionit.


- Është përgatitur lista e trajnimeve profesionale për stafin e TI në Departamentin e TI përfshirë edhe zyrtarët të TI së prokurorive.
- Është mbajtur takim me Komitetin e TI të institucionit të zbatimit të ligjit dhe temë e diskutimit ka qenë ndërlidhja e sistemeve elektronike me këto institucione.
- Në kuadër të Projektit KoSEJ II - Forcimi i cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë, është mbajtur takimi, me ç’rast është prezantuar Raporti i IV që përfshin: burimet buxhetore dhe ngarkesën në punë të lëndëve në prokurori / gjykatë.
- Pjesëmarrja me grupin punës për hartimin e Ligjit për Evidencën Penale e cila është organizuar nga Ministria e Drejtësisë.
- Trajnim për Menaxhim, komunikim dhe bashkëpunim të organizuar në kuadër të projektit “Mbështetje për një sistem prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm në Kosovë”
- Trajnimi hyrës për nëpunësit e ri civil në Shërbimin Civil të Kosovës të organizuar nga IKAP nga stafi i ri i TI.

#### 9.4.1. Divizioni i Infrastrukturës (rrjet dhe server)

Në kuadër të Divizionit për Infrastruktura janë realizuar aktivitete që kanë të bëjnë kryesisht me çështje të rrjetit dhe serverit për gjithë sistemin prokurorial.


Aktivitet me më rëndësi për këtë vit janë si në vijim:

- Është bërë furnizimi dhe monitorimi i vazhduar të shërbimit të rrjetit në sistemin prokurorial të Kosovës. Gjatë viti 2022 shërbimet e rrjetit në të gjitha objektet e prokurorive ka qenë aktiv 99.99% të kohës dhe tërësisht funksional me kapacitete të plota dhe trafik të enkriptuar, si në grafikun e mëposhtëm:



- Është trajtuar niveli i sigurisë brenda infrastrukturës së TI-së me prioritet të lartë, duke aplikuar praktikat më të mira për mbrojtjen ndaj qasjeve të paautorizuara, sulmeve kibernetike, mesazheve me përmbajtje të padëshiruar, etj. Janë implementuar të gjitha masat e sigurisë se rrjetit, edhe për kundër sulmeve dhe viruseve të ndryshme kemi qenë të mbrojtur mjaft mirë, ku kemi monitoruar vazhdimisht avarit e mundshme brenda rrjetit, në skemën e mëposhtme janë të paraqitura sulmet dhe tentimet për ndërhyrje brenda rrjetit:

Assessment Period: Wed Jun 1 2022 11:04:00 to Tue Nov 22 2022 11:00:00



#### RELEVANT ATTACKS CARRY THE FOLLOWING RISKS

Classification	Count
Attempted Administrator Privilege Gain	180
Web Application Attack	178
A Network Trojan was Detected	61
Attempted User Privilege Gain	12
Attempted Information Leak	3

- Infrastruktura e rrjetit është duke u mirëmbajtur vazhdimisht, me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve janë zëvendësuar pajisjet e rrjetit ku janë vendosur pajisje më të avancuar të cilat janë të menaxhueshme dhe ofrojnë shërbime më cilësore, këto instalime janë realizuar në Prokurorinë Themelore Prizren 2 switcha, Mitrovicë 3 switcha, Prokuroria Apel 1 switch dhe PSRK 3 switcha.
- Janë administruar zonat e sigurisë adekuatë, në veçanti DMZ e cila shërben për publikimin e shërbimeve jashtë domenit të KPK-s.
- Janë siguruar pajisje të rrjetit për nevojat të sistemit Prokurorial përmes donacionit nga Eulex.
- Janë mbajtur “update “ të gjithë kompjuterët me aplikacionin për mbrojtje nga viruset, për të minimizuar rrezikun që mund të shkaktojnë viruset e ndryshëm. Në tabelën e mëposhtme do të paraqesim numrin e kompjuterëve të cilët janë “update” vazhdimisht:

Time	Anti-virus and HIPS installed	Up-to-date computers
31/12/2021	771	763
31/01/2022	786	779
28/02/2022	817	810
31/03/2022	854	850
30/04/2022	872	865
31/05/2022	881	881
30/06/2022	887	890
31/07/2022	895	897
31/08/2022	913	917
30/09/2022	945	953
31/10/2022	953	958

- Infrastruktura e serverëve është rritur dukshëm gjatë vitit të fundit, si rezultat i rritjes së shërbimeve, aktualisht kemi 48 serverë virtual të gjithë janë 24/7 up time, vetëm gjatë vitit 2022 janë instaluar dhe konfiguruar 18 server me role të ndryshme të cilët ofrojnë shërbime të ndryshme brenda sistemit prokurorial.
- Është bërë shtimi i disqeve në njësit e disqeve për rritjen e kapacitetit të Qendrës së të Dhënave, për shkak të kostove të mëdha dhe versioneve të reja të disqeve cilat prezantohen nga prodhuesit, rritja është planifikuar të jetë konstante në secilin vit.
- Në Qendrën e të Dhënave, të gjitha sistemet operative edhe aplikative janë azhurnuar dhe janë në pajtim me rekomandimet e prodhuesve dhe procedurat standarde të operimit.
- Është bërë administrimi i arkivës digjitale (backup), përmes pajisjeve adekuate të cilat janë në Qendrën e të Dhënave, ku edhe realizohet arkivimi në Tape Disqe të cilat ruhen në sefa të sigurt. Në këtë arkiv digjitale për shkak të kapacitetit ruhen vetëm sistemet me rëndësi kritike për sistemin prokurorial.
- Është bërë auditimi i sistemeve, Active Directory dhe File server në vazhdimësi, ku edhe janë gjeneruar raportet me lloga të veprimeve.
- Është krijuar ekipi për mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave standarde në të gjithë sistemin prokurorial. Pas raportimit të të gjeturave dhe dhënies së rekomandimeve janë ndërmarrë veprime të cilat kanë përmirësuar gjendjen në të gjitha sajtet.
- Është realizuar mbikëqyrja e punimeve të cilat bien në fushëveprimin e DTI-së, në objektin e renovuar të PSRK-së. Gjatë gjithë procesit është raportuar për punimet si dhe janë dhënë rekomandimet e nevojshme.
- Në bashkëpunim me Projektin EukoJust është përgatitur raporti i gjendjes aktuale të infrastrukturës së Teknologjisë Informative për të gjitha Prokuroritë Themelore dhe Prokurorinë e Apelit.
- Në Qendrën e të dhënave në Pallatin e Drejtësisë është bërë servisimi i rregullt i sistemeve: Sistemi i klimatizimit, sistemi i menaxhimit të qasjes, sistemi i kamerave, sistemi i lagështisë, sistemi kundër zjarrit dhe sistemi i UPS. Të gjitha serviset janë kryer sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe në pajtim me kushtet e kontratës.
- Është bërë migrimi i serverëve fizik në server virtual, ndërsa serverët fizik janë konfiguruar që të shërbejnë si server replikimi për ngritjen e nivelit të diponshmërisë së shërbimeve.



- Është përgatitur plani për implementimin, konfigurimin, dizajni logjik dhe fizik për ndërlidhjen e Qendrës së të dhënave me Qendrën e Rimëkëmbjes.
- Është mirëmbajta dhe janë azhurnuar të dhënat në adresarin elektronik dhe posten elektronike për të gjithë të punësuarit në sistemin prokurorial. Në të cilin përfshihet aktivizimi i përdoruesve të riinj, bllokimi i përdoruesve, përditësimi i të dhënave, resetimi i fjalëkalimit, rritja e afatit të validitetit dhe rritja e kapacitetit të mailbox-it. Në raste kur kapaciteti i email-ave kalon kapacitetin maksimal prej 5GB, është bërë arkivimi lokal i email-ave.
- Është bërë përgatitja e specifikacionit teknik për furnizim me pajisje për Qendrën e Rimëkëmbjes e cila planifikohet të ndërtohet në Pejë nga Agjensioni i Shoqërisë së Informacionit.
- Është bërë furnizimi me licenca softuerike për ngritjen e nivelit të sigurisë së informacionit në sistemin prokurorial të Kosovës.
- Është bërë avancimi i pajisjeve të sigurisë së objekteve të sistemit prokurorial (këtu nuk është përfshirë objekti i PTH Prishtinë). Është rritur numri i pajisjeve për të mbuluar të gjitha këndet e mundshme, po ashtu janë rritur kapacitetet e disqeve në të gjitha objektet të kemi së paku 30 ditë incizim.
- Është mirëmbajtur infrastruktura e telefonisë fikse në tërë sistemin prokurorial.
- Është bërë implementimi i sistemit të telefonisë VoIP në objektet e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurorisë Themelore Pejë, Prokurorisë Themelore Mitrovicë, Prokurorisë Themelore Prizren, Prokurorinë Speciale dhe Prokurorinë e Apelit. Gjithsejtë janë instaluar 202 numra të rinj ku përfshihet, ndërsa janë demoluar 102 numra të telefonisë standarde me linja bakri.
- Është bërë furnizimi me pajisje me TI-së për nevojat e sistemit prokurorial (gjithsejtë 113 shtëpiza, 116 monitor dhe 9 laptop).
- Është bërë menaxhimi me pajisjet me qira për printim dhe skanim të dokumenteve. Gjatë vitit 2022 ka menaxhuar dhe administruar me 448 pajisje të ndryshme, siç janë fotokopje, printer dhe skaner.
- Është mbajtur trajnimi i stafit të TI për standardet e sigurisë ISO27001 dhe CCNA DataCenter të financuar nga Projekti MCC.
- Është mbajtur takim me përfaqësuesit e Projektit EUKOJUST dhe është diskutuar përgatitja e Procedurave Standarde të Veprimit për mirëmbajtjen e Qendrës së të dhënave, Sigurisë së Informacionit, mirëmbajtja e sistemeve elektronike etj.
- Në bashkëpunim me Agjensionin e Shoqërisë së Informacionit kemi filluar avancimin e sigurisë së informacionit - TI përkatësisht instalimin e sistemeve që ndërlidhen me siguri.
- Janë vendosur kontaktet e para me CERT-KOS nga ARKEP dhe kemi filluar testimet e para në IP publike të rezervuara si dhe filtrimet e rrjetit përmes ISP.
- Është bërë avancimi i kompjuterëve ekzistues për stafin e prokurorive me qëllim të ngritjes së performancës së pajisjeve në punë.
- Është përgatitur infrastruktura për kalimin e të gjitha shërbimeve nga operatori ArtMotion në shërbime të kontraktorit të ri TelKos. Përgatitjet janë realizuar në atë mënyrë që mos të kemi asnjë ndërprerje të shërbimeve dhe funksionimi të plotë të infrastrukturës.

- Janë përgatitur specifikat teknike për pajisjet simultante për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorinë Speciale. Po ashtu janë mirëmbajt të gjitha pajisjet e përkthimit simultant dhe pajisjet për “online meeting” në tërë sistemin prokurorial. Gjatë vitit 2022 janë realizuar të gjitha takimet, trajnimet dhe video thirrjet e përcaktuara përmes llogarive të licencuara dhe pajisjeve adekuate.
- Në sistemit prokurorial janë realizuar 10193 intervenime të stafi i sistemin prokurorial për ofrimin e mbështetjes për përdorimin e pajisjeve të TI dhe sistemeve elektronike.

#### 9.4.2. Divizioni për Sisteme Elektronike (softuer)

Në kuadër të Divizionit për Sisteme Elektronike janë realizuar një sërë aktiviteteve sipas planifikimit dhe nevojave.

Ndër aktivitetet kryesore të zhvilluara nga ky divizion janë:

- Konform Rregullores nr. 02/2022 është bërë ndryshimi dhe avancimi i sistemit për aplikim Online për pozitën e Prokurorit të Shtetit si dhe ka qenë i zbatueshëm në konkursin e shpallur gjatë muajit mars '22 për Prokurorin e Shtetit.
- Është avancuar Sistemi për Elektronik për Menaxhimin e Dosjeve të Prokurorëve përkatësisht modulet: Avancimi prokurorëve, Trajnimi dhe Disiplina.
- Është përgatitur specifikacioni teknik për hapjen e faqeve në rrjetet sociale si dhe krijimin i një kanalit në youtube. Projekti është dërguar te Ambasada Amerikane për mbështetje financiare.
- Është përgatitur specifikacioni teknik për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e ueb protalit për sistemin prokurorial të Kosovës. Projekti është dërguar te UNDP për mbështetje financiare.
- Është përgatitur dhe dërguar kërkesa - GIZ - Gjerman për mbështetje financiar në avancimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Lëndëve në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave.
- Është realizuar përditësimi i të dhënave në adresarin e brendshëm të KPK-s dhe në adresarin e emailave për të gjithë ata të cilët kanë pasur ndryshime në pozita, numra të telefonit dhe të dhënat e tjera.
- Është përgatitur specifikacioni teknik për zhvillimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e sistemit elektronik për menaxhim të dokumenteve e-libraria për sistemin prokurorial të Kosovës. Projekti është dërguar te UNDP për mbështetje financiare.
- Është përgatitur specifikacioni teknik për zhvillimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e sistemit elektronik menaxhimin e buxhetit, financave dhe shërbimeve të përgjithshëm për sistemin prokurorial të Kosovës. Projekti është dërguar te EUKOJUST për mbështetje financiare.
- Në bashkëpunim me stafin e Policisë së Kosovës është bërë avancimi i shkëmbimit të të dhënave, me qëllim që tërë procesi i punës të përcjellët nga sistemet që janë në përdorim.

- Mirëmbajtja dhe ofrimi i përkrahjes për Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Vijueshmërisë në Punë.
- Mirëmbajtja dhe ofrimi i përkrahjes për Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Rasteve të Profilit të Lartë, bashkërendimi i aktiviteteve me institucionet e tjera si KGJK, Policia e Kosovës, ATK, Dogana dhe Njësia e Inteligjencës Financiare, institucione këto që përdorin sistemin.
- Mirëmbajtja dhe ofrimi i përkrahjes për Sistemin për Menaxhimin e Rasteve të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit - KrimKORR.
- Mirëmbajtja dhe ofrimi i përkrahjes për Sistemin për Menaxhimin e Veturave.
- Mirëmbajtja dhe ofrimi i përkrahjes për Sistemin për Menaxhimin e Arkiva.
- Ka filluar punën 1 zyrtar: një Administrator i Lart i bazave të të dhënave.

#### 9.5. Projekti TIK/SMIL

Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve është duke u zbatuar në prokuroritë themelore në Prishtinë, Pejë, Gjiçan, Gjakovë, Ferizaj, Prizren, Prokurorinë Speciale, Prokurorin e Apelit ndërsa në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit ka fillua trajnimi i stafit administrativ dhe prokurorëve.

Gjatë këtij viti është vënë në zbatim shpërndarja automatike e lëndëve në Prokurorin Themelore Prishtinë në përputhje me Rregulloren për Administrimin dhe ndarjen e lëndëve në Prokurorin e Shtetit.

Janë mbajtur takimet e rregullta të Bordit të Projektit si dhe të Grupit Punues të përdorueseve për mbikëqyrjen e zbatimit të Projektit TIK/SMIL.

Në bashkëpunim me stafin e TI të Administratës Tatimore të Kosovës është finalizuar Procedura Standarde e Operimit për shkëmbimin elektronik të të dhënave në mes të prokurorisë dhe ATK.

Është përgatitur raporti i shkëmbimit elektronik të të dhënave në mes të prokurorisë dhe Policisë i cili përmban informatat lidhur me sfidat të shfaqura nga Policia gjatë dërgimit të lëndëve përmes sistemit në prokurori.

Janë mbajtur takime të rregullta me zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe janë diskutuar sfidat të cilat janë identifikuar gjatë shkëmbimit elektronik të të dhënave në mes prokurorisë dhe policisë.

Është bërë pranimi i dokumentacionit dhe kodit burimor të SMIL nga operatori si rezultat i përfundimit të kontratës të nënshkruar me kompaninë konsulente Norvegjeze (IMG).

Është përgatitur raporti i punës së Projektit TIK/SMIL i cili përfshinë të gjitha aktivitetet të realizuara gjatë periudhës janar – dhjetor 2022.

Me vendimin nr. 1407/2021 të datës 30 shtator 2021, Komisioni për Administrimin e prokurorive ka themeluar Grupin Punues për monitorimin e zbatimit të Sistemit Elektronik për Menaxhimin e rasteve (SMIL) në prokuroritë e Republikës së Kosovës. Gjatë vitit janë bërë vizita si dhe janë përgatitur raporte për zbatimin e SMIL për të gjitha Prokurorit Themelore dhe Prokurorinë e Apelit.

Është mbajtur punëtorja me temën Prezantimi i raporteve për monitorimin e zbatimit të SMIL. Kjo punëtori është organizuar nga Komisioni për Administrimin e Prokurorive në bashkëpunim me Projektin EUKOJUST dhe pjesëmarrës ishin: Administratorët, Udhëheqësit e shkrimores dhe trajnerët e TI.

Është përgatitur plani për ri-trajnimin e të gjithë prokurorëve dhe stafit administrativ në përdorimin e SMIL. Po ashtu janë mbajtur trajnime për të gjithë stafin të cilët janë identifikuar që kanë nevojë në përdorimin e SMIL.

Janë mbajtur takimet e rregullta me Trajnerët e Projektit TIK/SMIL, dhe temat e diskutimit: zbatimi i SMIL.

Është mbajtur takim me përfaqësuesit e Mjekësisë Ligjore si dhe kompaninë e kontraktuar nga ta për të diskutuar mundësinë e ndërlidhjes së SMIL me sistemin i cili do të vihet në zbatim nga ana e Mjekësisë Ligjore.

Është vënë në zbatim certifikata e re digjitale e lëshuar nga MAP për ndërlidhjen e SMIL me GG- (Government Gateway).

Janë mbajtur takime me përfaqësuesit e CEPEJ ku është diskutuar mundësia e ofrimit të mbështetjes për avancimin e procesit të vlerësimit të prokurorëve si dhe raportet që gjeneorhen nga sistemi elektronik SMIL.

Është mbajtur takim me përfaqësuesit e Doganave dhe pjesë e diskutimit ishte mundësit teknike për shkëmbimin elektronik të të dhënave në mes të prokurorisë (SMIL) dhe Doganës, është nënshkruar dhe marrëveshja për shkëmbim elektronik të të dhënave.

Kemi mbajtur takime me përfaqësuese nga projekti CEPEJ, me ç' rast janë prezantuar format e raporteve statistikore nga SMIL si dhe dashbord-i.

Janë mbajtur takime me përfaqësuesit të projektit CEPEJ dhe të NCCR, temë e diskutimit ishin Raportet statistikore të cilat gjenerohen nga SMIL si dhe të dhënat e regjistrimit të palëve (sigurimi i nr. personal) në SMIL. Përfaqësuesit e projektit shprehen vullnetin të na mbështesin në aktivitetet të cilat ndërlidhen me SMIL përfshirë edhe raportet statistikore.

Kemi mbajtur takime me përfaqësuesit e EULEX ku është diskutuar për zbatimin e SMIL në të gjitha Prokurorit Themelore, Speciale, Apel dhe ZKPSH.

Në bashkëpunim me Projektin EUKOJUST është organizuar tryeza e cila është mbajtur me dt. 28-29 qershor ku është diskutohet zbatimi i Rregullores për administrimin e lëndëve përmes SMIL.

Gjatë këtij viti kemi arritur të avancojmë shkëmbimin elektronik të të dhënave me sistemin e Policisë së Kosovës duke mundësuar komunikimin e plotë në mes të prokurorisë - policisë përkatësisht shkëmbimin e të gjitha të dhënave në mënyrë elektronike.

Është mbajtur takim me Rrjetin e Grave të Kosovës, me ç' rast është prezantuar mënyra e regjistrimit të palëve në SMIL dhe mundësit të cilat i ofron sistemi elektronik.

Kemi avancuar ndërlidhja e SMIL të prokurorisë dhe gjykatave duke mundësuar shkëmbimin elektronik të pothuajse të gjitha llojeve të veprimeve që ndërmerren nga ana e përdoruesve gjatë procesit të trajtimit të lëndëve.

Me qëllim të zbatimit të SMIL dhe identifikimit të sfidave eventuale që mund të paraqiten, Departamenti i TI ka mbajtur takimet të rregullta me Administratorët e prokurorive, udhëheqësit e shkrimoreve, si dhe me stafin e Policisë së Kosovës.

## VII. PJESA E SHTATË

### 10. Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë (tutje: Njësi), duke u mbështetur në kompetencat ligjore, gjatë vitit 2021 ka realizuar mbështetjen për Këshillin në proceset, si, rekrutimin, transferimin dhe avancimin e prokurorëve të Shtetit, vlerësimin e performancës së prokurorëve të Shtetit, administrimin e prokurorive, mbikëqyrja dhe raportimi për punën e prokurorive, vlerësimin e nevojave për trajnim të prokurorëve dhe mbajtjen e shënimeve dhe bazave të të dhënave për punën e prokurorive.

Gjithashtu, Njësi është angazhuar në ofrimin e mbështetjes për hartimin e akteve nënligjore të Këshillit, hartimin e dokumenteve strategjike dhe mbështetjen gjatë implementimit të SMIL-it.

Njësi i ka zhvilluar këto aktivitete nën mbikëqyrjen dhe koordinimin e drejtpërdrejtë të Drejtorit të NJSHP-së dhe përmes:

- Zyrës për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial;
- Zyrës për Statistika dhe
- Zyrës së Trajnimeve.

#### 10.1. Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial

Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial (më tej: ZMAVP) bazuar në përgjegjësitë dhe mandatin e saj të përcaktuar me rregullore, gjatë vitit 2021 ka realizuar aktivitetet të cilat kanë pas në fokus zbatim e këtij mandati, me theks të veçantë në ofrimin e mbështetjes profesionale, administrative dhe teknike për Këshillin, përkatësisht Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej: SKPK), Prokurorinë e Shtetit dhe komisionet e përhershme dhe ad hoc të Këshillit, në të gjitha proceset e zhvilluara, ku roli i Njësitit përkatësisht ZMAVP-së ka qenë i përcaktuar me akt normativ apo në secilin rast kur është kërkuar mbështetja.

ZMAVP, përmes angazhimit të zyrtarëve të caktuar, ka mbështetur proceset e rekrutimit, transferimit, avancimit, duke përfshirë administrimin e prokurorive dhe hartimin e raporteve përkatëse, si dhe ka hartuar raporte periodike (tre, gjashtë, nëntëmujore dhe vjetore) të punës së Prokurorit të Shtetit, si dhe raporte analitike, krahasuese dhe të punës së mekanizmave të ndryshëm të sistemit prokurorial.

##### 10.1.1. Mbështetja e komisioneve të Këshillit

ZMAVP-ja ka ofruar mbështetje të vazhdueshme për Këshillin, Prokurorin e Shtetit, komisionet e përhershme dhe ad hoc të Këshillit, si dhe Sekretariatit (SKPK), si në vijim:

- ZKPSH-në, raporte statistikore për Konferencën Vjetore të Prokurorëve;
- Këshillin dhe Sekretariatit në hartimin e draftit të Planit të Punës për vitin 2022 dhe Raportin e punës për vitin 2021;

- Komisionin për Vlerësim të Performancës së Prokurorëve (KVPP) gjatë vlerësimit të performancës së prokurorëve përmes ofrimit të informatave të kërkuara;
- Komisionin për rekrutimin, transferimin dhe avancimin e prokurorëve në kuadër të procesit të zhvilluar gjatë vitit 2022;
- Komisionin për Administrimin e Prokurorive si komision i përhershëm në organizimin e takimeve dhe vizitave në terren të Komisionit dhe hartimin e raporteve analitike dhe krahasuese për Komisionin.
- Komisionin për Çështje Normative, si komision i përhershëm, për hartimin e draft rregulloreve të përcaktuara me planin e punës së Komisionit dhe Këshillit;

#### 10.1.2. Hartimi i raporteve

Gjithashtu, ZMAVP-ja ka hartuar raporte pune, analitike, krahasuese dhe raporte të tjera, si më poshtë:

- Raporti i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2021;
- Raportet periodike (3, 6 dhe 9 mujore) të punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2022;
- Raport për përputhshmërinë dhe saktësinë e shënimeve nga regjistri fizik në krahasim me SMIL-in për lëndët e ndryshme penale (PPN);
- Raport krahasues për numrin e lëndëve nga raportet fizike dhe SMIL-i për tremujorin e parë 2022;
- Raport analitik për me ngarkesën e prokurorive me lëndë për tremujorin e parë 2022 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021 (ky raport është pjesë e Planit të Punës së KPK-së për vitin 2022);
- Raport për numrin (më të lartë) të prokurorëve që kanë pasur prokuroritë themelore gjatë periudhës 5 vjeçare (2017-2021) sipas kërkesës së Komisionit për Administrimin e Prokurorive;
- Raport krahasues të lëndëve të raportuara nga Shkrimorja dhe prokurorët për PTH Mitrovicë sipas kërkesës së Komisionit për Administrimin e Prokurorive;
- Raporte për ngarkesën me lëndë të prokurorive, departamenteve dhe prokurorëve si dhe numrin e nevojshëm të prokurorëve nëpër prokurori;
- Raport informues për partner ndërkombëtarë, lidhur me numrin e përgjithshëm të prokurorëve dhe anëtarëve të KPK-së, moshën, strukturën etnike, gjinore dhe nivelit të prokurorive për periudha konkrete kohore;

#### 10.1.3. Aktivitete të tjera

Përveç mbështetjes për Këshillin dhe komisionet, hartimit të raporteve të ndryshme analitike dhe krahasuese, ZMAVP-ja ka realizuar edhe aktivitete të tjera, si më poshtë:

- janë mbajtur takime dhe janë dhënë komentet përkatëse për funksionimin e moduleve të zhvilluara nga kompania në databazën SEMDP si dhe forma e raporteve;
- janë përditësuar shënimet në databazën SEMDP që kanë të bëjnë me avancimin dhe transferimin e prokurorëve;
- janë hartuar raportet statistikore infografike për uebportalin e sistemit prokurorial;

- janë dhënë komentet dhe rekomandimet për zhvillimin e formave të raporteve statistikore, të cilat do të zhvillohen për përdorim në SMIL;
- janë hartuar raportet për buletine për aktivitetet e realizuara nga ZMAVP/NJSHPP-ja;
- është përgatitur raport informues lidhur me aktivitetet e realizuara nga ZMAVP/NJSHPP të përcaktuara me Planin Strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024;
- është përgatitur raport për zbatimin e Planit të Punës së KPK-së për periudha të caktuara të vitit 2022, në aktivitetet ku ka qenë i përfshirë ZMAVP/NJSHPP;
- është mbështetur organizimi i Testit Kualifikues dhe Testit me Shkrim për kandidatët të cilët kanë aplikuar për pozitën Prokurorë të Shtetit;
- pjesëmarrje në takime pune, punëtori, tryeza pune dhe trajnime për ngritje të kapaciteteve për rritjen e performancës në punë;
- janë realizuar edhe aktivitete të tjera sipas kërkesave të autoriteteve kompetente të sistemit prokurorial të Kosovës.

## 10.2. Zyra për Statistika

Zyra për Statistika (më tej: ZS) gjatë vitit 2022 ka kryer punët sipas Planit të punës të ZS-së, si dhe punët e tjera nga kompetenca e përcaktuar me Rregulloren e NJSHPP-së. ZS, gjatë kësaj periudhe: Ka grumbulluar të dhëna statistikore për punën e prokurorive dhe prokurorëve, ka përpunuar ato dhe ka hartuar-përpiluar raporte statistikore dhe narrative (përshkruese) në baza: mujore, periodike (tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore) dhe vjetore. Ka mbështetur me të dhëna të nevojshme statistikore: Komisionet e përhershme të KPK-së; Koordinatorët nacional për luftimin e krimit, sipas grupeve të veprave penale, të caktuar nga KPK. Po ashtu, ZS, ka mbështetur dhe DTI-në gjatë fazës së implementimit të SMIL në veçanti Modullit për Statistika.

### 10.2.1. Mbështetja e komisioneve, koordinatorëve nacionalë, DTI-së dhe ZMAVP-së

ZS ka ofruar mbështetje profesionale dhe me të dhëna statistikore, komisionet e përhershme të KPK-së, Koordinatorët nacional për luftimin e krimit sipas grupeve të veprave penale, DTI dhe ZMAVP, si në vijim:

- Komisioni për vlerësimin e performancës së prokurorëve, është mbështetur me informata dhe dhëna statistikore, specifike, për punën e 61 prokurorëve ( 57 të rregullt dhe 4 të parregullt), të cilët gjatë këtij viti iu janë nënshtruar procesit të vlerësimit të performancës;
- Komisioni për Administratë është mbështetur me të dhëna statistikore për gjendjen numerike të rasteve, sipas departamenteve dhe llojeve të regjistrave; Po ashtu ky Komision është mbështetur edhe gjatë vizitave monitoruese që ndërliken me implementimin e SMIL;
- Zyra e Koordinatorit Nacional për Luftimin e Krimeve Ekonomike është mbështetur me të dhëna statistikore dhe informata nga Grupi i këtyre veprave penale;
- Koordinatori Nacional për Luftimin e Trafikimit të Qenie Njerëzore është mbështetur me të dhëna statistikore për rastet dhe personat nga ky grup i veprave penale. Po ashtu, ZS-ja ka grumbulluar edhe të dhëna specifike statistikore për këto vepra, sipas kërkesave nga DASH-i (Ambasada Amerikane);



- Koordinatori Nacional për Luftimin e Veprave Penale të Korrupsionit është në mbështetje të vazhdueshme nga ZS-ja me të dhëna të ndryshme statistikore për këtë grup të veprave penale;
- Departamenti i Teknologjisë Informative është mbështetur gjatë implementimit të SMIL-modulit të raporteve statistikore nga dy zyrtarë të ZS-së, të cilët në cilësinë e anëtarëve të Grupit punues për monitorimin e zbatimit të SMIL kanë dhënë kontribut gjatë vizitave të planifikuara në tri prokurori, në të cilat janë identifikuar pengesat dhe problemet gjatë implementimit të SMIL-it;
- Zyrtarët e ZS-së rregullisht bëjnë testimin e raporteve që gjeneron SMIL-i dhe rregullisht njoftojnë DTI-në në lidhje me problemet (deri më tani asnjë raport statistikor nuk është i përdorshëm, i saktë);
- ZMAVP-ja dhe ZS-ja bëjnë një punë të përbashkët në verifikimin e të dhënave statistikore të raportuara. ZS, sipas nevojës dhe kërkesës, këtë zyrë e mbështet në aspektin teknik dhe profesional në përdorimin e të dhënave statistikore si dhe interpretimin e tyre.

#### 10.2.2. Grumbullimi i të dhënave statistikore, përpunimi i tyre dhe përpilimi i raporteve statistikore

Zyra për Statistika gjatë vitit 2022 ka grumbulluar të dhëna statistikore, i ka përpunuar dhe ka përpiluar raporte statistikore standarde dhe të veçanta, në baza mujore, periodike dhe vjetore, sipas llojeve në vijim:

- Raportet **mujore** statistikore, për:
  - ngarkesën e prokurorëve me lëndë si dhe efikasitetin në zgjidhjen e tyre, sipas departamenteve dhe llojit të , për secilin prokuror veç e veç, të prokurorive themelore, Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë së Apelit;
  - gjendjen numerike të rasteve në prokurori: sipas prokurorive, departamenteve si dhe sipas llojit të regjistrave;
  - gjendjen numerike të rasteve sipas grupeve të veprave penale nga mekanizmi përcjellës nga regjistri PP dhe PPN.
- Raportet statistikore për % e **përbushjes së Normës Orientuese**, për vitin 2020, për **182** prokurorë, të prokurorive themelore, Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë së Apelit. Raporti me normat e llogaritura i secilit prokuror, është vendosur si dokumentacion në Dosjen personale në sistemin elektronik (SEM DP);
- Raportet periodike statistikore: **Tremujore, Gjashtëmujore, Nëntëmujore dhe Vjetore**:
  - Raporte standarde për punën e prokurorive themelore dhe PSRK, për:
    - kryes të veprave penale me persona madhor (PP);
    - kryes të veprave penale persona të mitur (PPM),
    - kryes të panjohur të veprave penale (PPP),
    - pretendimet për kryerjen e veprave penale (PPN, PPNM),
    - ndihmë juridike ndërkombëtare (NJN);
    - raportet për aplikimin e procedurave alternative;
    - raportet për integritet evropiane, veprat penale: dhunë në familje, kundër komunitetit të gazetarëve dhe Komunitetit LGBTI;

- raportet pasqyrohen për secilën prokurori dhe departament.
- Raporte statistikore për punën e Prokurorisë së Apelit sipas departamenteve dhe llojit të regjistrave;
- Raporte statistikore për punën e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, sipas llojeve të regjistrave;
- Raporte standarde për grupet e veprave nga Mekanizmi përcjellës: armët, droga, krimi i organizuar, krimet ekonomike, korrupsioni, kontrabanda e migrantëve; shpëlarje e parave, veprat penale të motivuara nga urrejtja dhe trafikimi i qenieve njerëzore;
- Raporte përshkruese për punën e prokurorive dhe veprave penale karakteristike nga Mekanizmi përcjellës;
- Raporte të veçanta:
  - Raporte statistikore për shqiptimin e masave të diversitetit për persona të mitur-fëmijë sipas: gjinisë, grupmoshave, llojit të masës së shqiptuar, llojit të veprës penale si obligim ndaj Ministrisë së Drejtësisë (raporti vjetor);
  - Regjistri-lista-raporti statistikor për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore duke përfshirë edhe të dhënat për viktimat: gjinia, mosha, shtetësia, qëllimi i trafikimit, periodike dhe vjetore për nevojat e Koordinatorit Nacional për Luftimin e Veprave Penale të TQNJ-së;
  - Raporte statistikore për MSA-në;
- Raporte të tjera statistikore, sipas kërkesave:
  - Raporte të veçanta mujore, për rastet dhe personat me vepra penale të korrupsionit për lëndët e pazgjidhura, lëndët e pranuar, lëndët e zgjidhura sipas numrit të lëndës, datës së pranimit të lëndës, parashtruesit të kallëzimeve penale, mënyrës së zgjidhjes, datës së zgjidhjes dhe vendimeve të gjykatave përkitazi me aktet akuzuese sipas kërkesës së IKD-së;
  - Raporte të ndryshme statistikore për lloje të ndryshme të veprave penale dhe për periudha të ndryshme kohore, sipas kërkesave të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, prokurorëve për pjesëmarrës në konferenca dhe punëtori, botës akademike dhe mediave.

### 10.3. Zyra për Trajnime

Zyra për Trajnime gjatë këtij viti ka zhvilluar aktivitetet për zhvillimin profesional të prokurorëve të shtetit dhe personelit administrativ në sistemin prokurorial për ofrimin e trajnimeve dhe aktivitetet e edukimit ligjor dhe studime me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së aftësive dhe shkathtësive dhe njohurive të tyre, që lidhen me detyrat e punës, si vijon:

- Në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës dhe donator të tjerë si institucionet ndërkombëtare si: Ambasada Amerikane në Prishtinë, ADC-ja, ICITAP-i, Këshilli i Evropës dhe Projekti “Mbështetje e reformës së Policisë” nga BE-ja që ka koordinuar aktivitetet për ngritjen profesionale të prokurorëve dhe personelin administrativ të prokurorive;

- Ka koordinuar punën për pjesëmarrjen e prokurorëve në programet e trajnimit të vazhdueshëm si dhe trajnimeve tjera, të cilat janë organizuar qoftë me pjesëmarrje fizike, po ashtu edhe të realizuara në formë virtuale në platformën elektronike “Zoom”;
- Ka hartuar planin e detajuar për nevojat e trajnimit për prokurorët dhe personelin administrativ të sistemit prokurorial;
- Ka hartuar dokumentin e politikave të trajnimit ku përcaktohen, parimet, objektiva, përmbajtja, metodologjia dhe kornizat e programit trajnues për prokurorët dhe personelin administrativ;
- Në kuadër të Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Dosjeve të Prokurorëve janë regjistruar dhe përditësuar me kohë të gjitha aktivitetet trajnuese për prokurorë;
- Ka hartuar raportet periodike, tre, gjashtë, nëntëmuor dhe njëvjeçar për pjesëmarrjen e prokurorëve në aktivitetet e edukimit ligjor;

## 11. Sfidat

Gjatë veprimtarisë së Këshillit për vitin 2022 sfidat kryesore ishin:

- Mosplotësimi i përbërjes së Këshillit me dy (2) anëtarë joprokurorë, që me hyrjen në fuqi të Ligjit për Këshillin Prokurorial në prill vitit 2019, nuk është përgjegjësi e Këshillit as përzgjedhja dhe as procedurat teknike të shpalljes së konkursit;
- Buxheti i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjitha obligimet e krijuara;
- Vonesa në dekretimin e Kryeprokurorit të Shtetit;
- Kushtet e vështira në Pallatin e Drejtësisë;
- Ndërmarrja e aktiviteteve të shumta për mbrojtjen e pavarësisë së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit;
- Vendimi i Qeverisë për uljen e pagave të prokurorëve;
- Specializimi i prokurorëve për trajtimin e krimeve karakteristike (korrupsioni, krimi i organizuar, krimi ekonomik dhe krimet kibernetike);
- Mosrespektimi i parimit të transparencës përmes disa publikimeve mediale që ndikojnë drejtpërdrejt në dëmtimin e besimit të publikut në sistemin prokurorial;
- Infrastruktura fizike (zgjerimi i hapësirave për Këshillin dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit) dhe
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit të sistemit prokurorial.